



# PËRDORIMI I INSTRUMENTEVE TË DIAGNOSTIKIMIT TË ÇRREGULLIMEVE NEUROZHVILLIMORE TE FËMIJËT E MOSHËS 5-10 VJEÇ



**Save the Children**

*Modul trajnimi*



**Save the Children**

## **MODUL TRAJNIMI**

# **MBI PËRDORIMIN E INSTRUMENTEVE TË DIAGNOSTIKIMIT TË ÇRREGULLIMEVE NEUROZHVILLIMORE TE FËMIJËT E MOSHËS 5-10 VJEÇ**

*Çrregullimet e të nxënit dhe të sjelljes / manual për  
diagnostikim të nxënësve në ciklin fillor*

**Përgatiti: Prof. Dr. Milika Dhamo**

**Tiranë, 2017**

Botimi i këtij manuali u mundësua nga Save the Children.

Save the Children është organizatë kryesuese në botë dhe e pavarur për fëmijë. Ne punojmë në 120 vende të botës. Ne mbrojmë jetën e fëmijëve; luftojmë për të drejtat e tyre dhe i ndihmojmë ata të përmbushin potencialin e tyre.

Tiranë, 2017

Ky manual vlerësimi hartohet në kuadrin e projektit “Arsimi Gjithëpërfshirës për Fëmijët me Nevoja të Veçanta Arsimore në Shqipëri” i mbështetur nga e financuar nga Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim AID 010155/STC/ALB, dhe i zbatuar në bashkëpunim me Ministrin e Arsimit dhe Sportit dhe shoqatën MEDPAK.

Manuali është vlerësuar nga Instituti i Zhvillimit të Arsimit.

Autor:

Prof. dr. Milika Dhamo

Koordinatorë projekti:

Msc. Dhurata Nixha

Redaktorë shkencorë:

Instituti i Zhvillimit të Arsimit –IZHA

Redaktor gjuhësorë:

Msc. Olger Brame

Materialet e këtij botimi mund të riprodhohen, të ruhen në sisteme të përdorueshme apo të transmetohen në forma e mënyra elektronike, mekanike apo duke u fotokopjuar, pa patur nevojë për të marrë leje më parë nga “Save the Children”, por në çdo rast duke cituar burimin, nga i cili janë marrë.

Ky libër nuk mund të shitet ose të përdoret për qëllime përfitimi.

## Përmbajtja

|   |           |
|---|-----------|
| “Mbi përdorimin e instrumenteve të diagnostikimit të çrregullimeve neurozhvillimore në arsimin fillor” .....                      | 5         |
| Mbi përdorimin e instrumenteve të diagnostikimit të nxënësve Klasa I-V .....  | 6         |
| <b>PJESA 1</b> .....  | <b>7</b>  |
| 1. PAAFTESIA INTELEKTUALE.....  | 7         |
| 2. ÇRREGULLIMET E KOMUNIKIMIT .....   | 7         |
| 2. a. Çrregullimet gjuhësore Kodi: 315.39 (F80.9).....  | 7         |
| 2.b. Çrregullimet e të folurit Kodi: 315.39 (F80.0).....  | 9         |
| 2. c. Çrregullimi i pragmatizmit të komunikimit (komunikimit social) Kodi: 315.39 (F80.89) .....                                  | 11        |
| 2.c. Çrregullimi i pragmatizmit të komunikimit (komunikimit social) Kodi: 315.39 (F80.89).....                                    | 11        |
| 2.d. Çrregullimi i mbajtjes së gojës Kodi: 315.35 (F80.81).....   | 12        |
| 2.e. Çrregullime të paspecifikuara të komunikimit Kodi: 307.9 (F80.9) .....   | 13        |
| 3. ÇRREGULLIMET E SPEKTRIT TË AUTIZMIT Kodi: 299.00 (F84.0).....  | 13        |
| 4. CRREGULLIMET E INHIBIMIT (çrregullim i lehtë, i moderuar, i rëndë) .....   | 16        |
| 4.a. ADHD (tipi i çrregullimit të vëmendjes me hiperaktivitet, niveli i lehtë, i moderuar,<br>i rëndë) Kodi: 314.01 (F90.2) ..... | 16        |
| 4.b.ADD (tipi i çrregullimit të vëmendjes, niveli: i lehtë i moderuar, i rëndë) Kodi: 314.00 (F90.0) .                            | 16        |
| 4.c. HD (tipi i çrregullimit të hiperaktivitetit, niveli: i lehtë i moderuar, i rëndë)<br>Kodi: 314.01 (F90.1) .....              | 16        |
| 5. ÇRREGULLIME SPECIFIKE TË TË NXËNIT (të lehta, të moderuara, të rënda).....   | 19        |
| 5.a. Çrregullimet në lexim (disleksi) Kodi: 315.00 (F81.0) .....  | 19        |
| 5.b. Çrregullimet në shkrim Kodi: 315.2 (F81.81).....   | 19        |
| 5.c. Çrregullimet në matematike Kodi: 315.1 (F81.2) .....   | 19        |
| 6. ÇRREGULLIMET MOTORE Kodi 315.4 (F82).....  | 21        |
| 6.a. Çrregullimi i lëvizjeve stereotipike Kodi: 307.3 (F98.4) ((i lehtë, i moderuar, i rëndë:<br>me/pa dëmtim të vetes).....      | 22        |
| 7. ÇRREGULLIMET NEUROZHVILLIMORE TË PASPECIFIKUARA Kodi: 315.9 (F89) .....  | 22        |
| <b>PJESA II: VEPRIMTARI</b> .....   | <b>23</b> |
| VEPRIMTARIA 1: ÇRREGULLIMET E KOMUNIKIMIT .....   | 24        |
| VEPRIMTARIA 2: ÇRREGULLIME TË SPEKTRIT TË AUTIZMIT Kodi: 299.00 (F84.0) .....   | 32        |
| VEPRIMTARIA 3: ÇRREGULLIMET E INHIBIMIT (çrregullim i lehtë, i moderuar, i rëndë) (1.5 ore) .....                                 | 35        |
| VEPRIMTARIA 4: ÇRREGULLIME SPECIFIKE TË TË NXËNIT (të lehta, të moderuara, të rënda) (3 orë) 38                                   |           |
| VEPRIMTARIA V: ÇRREGULLIMET MOTORE Kodi 315.4 (F82) 9   |           |



# “Mbi përdorimin e instrumenteve të diagnostikimit të çrregullimeve neurozhvillimore në arsimin fillor”

Moduli “Mbi përdorimin e instrumenteve të diagnostikimit të çrregullimeve neurozhvillimore në arsimin fillor” që u ofrohet specialistëve që trajtojnë fëmijët me çrregullime zhvillimi (mësues, psikologë, terapistë, mjekë si dhe prindërve të tyre) ka qëllime të shumfishta. Ai është hartuar për të plotësuar boshllëkun aktual në sistemin e referimit, vlerësimit dhe diagnostikimit të fëmijëve 6-10 vjeç me çrregullime neurozhvillimore. Moduli synon të adresojë nevojat e prindërve dhe mësuesve për të referuar fëmijën e dyshuar për çrregullime neurozhvillimore për vlerësim profesional dhe diagnostikim me ndikim në trajtimin e mëvonshëm të fëmijës. Moduli synon të plotësojë edhe nevojat e psikologëve shkollorë për të përdorur instrumente bashkëkohore në vlerësimin dhe diferencimin e diagnozave në zhvillimin e nxënësve në klasat I-V.

Ky modul trajnimi ofrohet për aftësimin e aktorëve të mësipërm në përdorimin e manualit ‘Instrumente të diagnostikimit të çrregullimeve neurozhvillimore te fëmijët e moshës 6-10 vjeç’ i cili përmban një set të mirorganizuar instrumentesh sipas DSM-V, në përpjekje për të unifikuar vlerësimin dhe diagnostikimin e çrregullimeve neurozhvillimore të fëmijës në moshën 5-10 vjeç me praktikën botërore. Instrumentet janë ndërtuar në mënyrë të tillë që të mund të përdoren si nga prindërit dhe mësuesit (pjesa e karakteristikave të sjelljes) ashtu edhe nga psikologët shkollorë (pjesa e matrikular). Manuali “Instrumente të diagnostikimit të fëmijëve me çrregullime neurozhvillimore” mund të përdoret periodikisht, duke u bërë edhe baza e mbledhjes së të dhënave të zhvillimit të fëmijës në ato aspekte ku manifestohet çrregullimi (një herë në 6 muaj, ose një herë në vit). Ai ofron mundësinë e depozitimit të të dhënave metrike të sjelljes, duke krijuar mundësinë e një baze të dhënash mbi zhvillimin, si dhe mundësinë për të bërë matje të krahasueshme me basën fillestare të të dhënave në vitet më vonë. Ai u ofron specialistëve mundësinë për të marrë vendime të informuara në përcaktimin e trajtimit pedagogjik, psikologjik, terapeutik, edukativ, sjellor, mjekësor e social të fëmijës me çrregullime neurozhvillimore. Ai është një shans për të unifikuar sistemin e referimit, të vlerësimit dhe diagnostikimit të çrregullimeve neurozhvillimore në të gjithë sistemin arsimor dhe aktorët e tij.

Moduli i ofruar synon të aftësojë prindërit, mësuesit dhe psikologët shkollorë të njohin karakteristikat e çrregullimit të paaftësisë mendore: të lehtë, të moderuar, të rëndë e të thellë; karakteristikat e çrregullimeve të komunikimit: çrregullimet gjuhësore, të folurit, të komunikimit social, të mbajtjes së gojës; karakteristikat e çrregullimeve të spektrit të autizmit; karakteristikat e çrregullimeve të inhibimit: AHDH, HD, ADD; karakteristikat e çrregullimeve specifike të të nxënësve: disleksia, disgrafia, diskalkulia si dhe karakteristikat e çrregullimeve motore e sensore siç përshkruhen në manual. Ai synon të aftësojë prindërit dhe mësuesit ku të fokusojnë vërejtjet e sjelljes së fëmijës së dyshuar për çrregullime në zhvillim dhe psikologët si të bëjnë dhe të llogarisin matjet e duhura. Të dhënat e mbledhura përmes instrumenteve diagnostikues janë të lexueshme dhe të përdorshme nga grupe multidisiplinare, me qëllimin të ndihmojë në përcaktimin e drejtimeve ku do të punojë secili specialistet (çfarë do të marrë përsipër PEI në shkollë, terapia jashtë, mjeku apo shërbimi social lokal).

Moduli i ofruar është një mundësi për të njësuar praktikën e vlerësimit të fëmijëve me çrregullime neurozhvillimore dhe krijimin e mundësive për trajtime të specializuara dhe të diferencuara në gjithë sistemin arsimor përmes përdorimit të manualit të indikatorëve. Ai i ofrohet çdo specialisti të interesuar apo anëtari të ekipit të trajtimit të fëmijës: prindërve, familjarëve, kujdestarëve, ofruesve

të shërbimeve terapeutike, mjekëve, planifikuesve dhe zbatuesve të shërbimeve të specializuara në arsimin fillor në shkolla publike dhe private.

Teknikisht, ky modul i hartuar për trajnime të mësuesve dhe psikologëve shkollorë në shkollat fillore ka të mirëparashtruar metodologjinë e përdorimit të tij. Moduli dhe materialet bashkëshoqëruese përmbajnë platformat e vëzhgimit të sjelljes së fëmijës, kushtet e vëzhgimit, si edhe një metrikë përcaktuese për vendosjen e diagnozës. Në tërësi, përmes tyre ofrohet një sistem i unifikuar vëzhgimi për psikologët në fushë, si edhe një metrikë e domosdoshme në komunikimin midis specialistëve të zhvillimit të fëmijës. Manuali i instrumenteve ofron mundësinë që profesionistë të ndryshëm të dhënies së shërbimeve për fëmijët ta shikojnë veten anëtarë të një grupi multidisiplinar, ku secili punon në drejtim të përmirësimit të karakteristikave tipike të çrregullimit.

## Mbi përdorimin e instrumenteve të diagnostikimit të nxënësve Klasa I-V

**Qëllimi i trajnimit:** Aftësimi i aktorëve në shkollë në përdorimin e instrumenteve të vlerësimit të çrregullimeve neurozhvillimore te fëmijët në ciklin fillor (klasa 1-5).

**Objektivat e trajnimit:** Në përfundim të trajnimit pjesëmarrësit:

1. Do të njohin larminë e çrregullimeve neurozhvillimore te fëmijët e ciklit fillor (klasa 1-5)
2. Do të aftësohen të dallojnë karakteristikat tipike të çrregullimeve në të nxënë sipas përshkrimit respektiv në DSM-V;
3. Do të aftësohen të njohin kombinimet e çrregullimeve neurozhvillimore (çrregullimet komorbide);
4. Do të aftësohen të përdorin manualin e vlerësimit të çrregullimeve neurozhvillimore

**Kohëzgjatja e trajnimit:** 2 ditë

**Dita I**

8:30 - 9:00: regjistrimi/prezantimi i pjesëmarrësve  
9:00 - 9:30: prezantimi me objektivat e trajnimit  
9:30 - 11:00: paaftësia intelektuale  
11:00 -11:30: pushim kafe  
11:30 -1:00: çrregullimet e komunikimit  
1:00 - 2:00: pushim dreke  
2:00 - 4:00: çrregullimet e spektrit të autizmit  
4:00 - 4:30: vlerësimi i ditës së parë të trajnimit

**Dita II**

9:00 - 9:30: prezantimi me objektivat e trajnimit  
9:30 -11:00: çrregullimet e inhibimit  
11:00 -11:30: pushim kafe  
11:30 -1:00: çrregullimet neuromotore,  
1:00 - 2:00: pushim dreke  
2:00 - 4:00: çrregullimet specifike të të nxënës /komorbiteti i CN  
4:00 - 5:00: vlerësimi i dy ditëve të trajnimit.

Pjesa e parë e modulit përmban informacionin e nevojshëm teorik për psikologët e shkollave, mësuesit dhe prindërit. Njëkohësisht, kjo pjesë mbështet veprimtaritë e pjesës së dytë të trajnimit.

-

## 1. PAAFTESIA INTELEKTUALE

Paaftësia intelektuale/mendore është një nga trajtat më të rënda të çrregullimeve neurozhvillimore te fëmijët. Ajo mund të jetë:

1. Paaftësi e lehtë mendore - Kodi: 319 (F70)
2. Paaftësi e moderuar mendore - Kodi: 319 (F71)
3. Paaftësi e rëndë mendore - Kodi: 319 (F72)
4. Paaftësi e thellë mendore - Kodi: 319 (F73)

Fëmijët me paaftësi intelektuale karakterizohen nga deficite në shprehjet e përshtatjes dhe funksionimit intelektual në mjediset formale dhe informale (familje, grup, shkollë, komunitet). Deficitet vërehen në fushat e zhvillimit konjitiv, gjuhësor, emocional e social si dhe në zbatimin praktik të të shprehive në këto fusha.

Vlerësimi i fëmijës së dyshuar për paaftësi intelektuale bëhet nga mjeku specialist. Shërbimet edukative për fëmijët me paaftësi intelektuale mund të jepen në shkolla të përgjithshme dhe/ose në shkolla e/a institucione të specializuara.

## 2. ÇRREGULLIMET E KOMUNIKIMIT

Sipas DSM-V, në grupin e çrregullimeve të komunikimit përfshihen:

2. a. çrregullimet gjuhësore (dëmtimet neurogjenike, dëmtime të gjuhës receptive dhe/apo shprehëse),
2. b. çrregullimet e të folurit, (apraksia, disartria),
2. c. çrregullimet e komunikimit social (mungesa e pragmatizmit të gjuhës),
2. d. mungesën e rrjedhshmërisë së të folurit (disfluenca, mbajtja e gojës).
2. e. çrregullime të paspecifikuara të komunikimit

### 2. a. Çrregullimet gjuhësore Kodi: 315.39 (F80.9)

Kriteret e vlerësimit të çrregullimeve gjuhësore përfshijnë:

- A.** Vështirësi të përhershme në përftimin dhe përdorimin e modaliteteve të gjuhës (e folur, e dëgjuar, e shkruar, me shenja, etj.). Për shkak të mangësive (deficiteve) në të kuptuarit dhe në përdorimin e gjuhës, fëmijët manifestojnë:

- i. Fjalor të varfër
- ii. Struktura të varfra të fjalive
- iii. Çrregullime të bashkëbisedimit



**B.** Aftësitë gjuhësore janë dukshëm nën nivelin e moshës. Për shkak të mangësive (deficiteve) gjuhësore, fëmijët manifestojnë:

- i. Paaftësi për të komunikuar përmes gjuhës
- ii. Mungesë të pjesëmarrjes në grup apo e shoqërimit me të tjerë
- iii. Mungesë të arritjeve akademike

**C.** Shenjat e mësipërme duhet të kenë filluar në fëmijërinë e hershme

**D.** Vështirësitë dhe mangësitë (deficitet) e mësipërme nuk i atribuohen një çrregullimi tjetër (mungesës së të dëgjuarit, mangësive (deficiteve) motore apo kushteve të tjera mjekësore e neurologjike).

Çrregullimet gjuhësore kompromentojnë aftësinë për të marrë, dërguar, përpunuar dhe kuptuar informacionin verbal, joverbal, grafik dhe simbolik. Ato mund të jenë të fituara ose të lindura dhe variojnë në shkallë (i lehtë, i thellë), në tip (mund të jetë i heshtur ose i manifestuar hapur), në kohë (mund të jetë i lindur ose i fituar), në shkak (mund të jetë primar ose sekondar).

Në shumë fëmijë me çrregullime gjuhësore, gjuha është thuajse totalisht e munguar. Ata mund të diagnostikohen nga mjekët si afazikë. „Afazi“ do të thotë „pa gjuhë“, „humbje e gjuhës“. Afazia mbetet një nga çrregullimet më mistike neurozhvillimore, sidomos kur fëmija lind me paaftësinë për të prodhuar gjuhën. Prania e saj tregon se truri është dëmtuar/i pazhvilluar si në sipërfaqe ashtu edhe në thellësi. Fëmijët me afazi nuk arrijnë të flasin dhe/ose kuptojnë çfarë u thuhet. Ata bëjnë shumë përpjekje për të gjetur fjalët e duhura, por shpesh pa sukses. Në disa fëmijë, afazia prek si aftësinë për të folur, ashtu edhe aftësinë për të shkruar e lexuar. Ajo është shkak i pamundësisë për të njohur simbolikën matematikore, apo për të bërë interpretimin e sinjaleve akustike dhe gjestikulative. Ajo e bën të pamundur interpretimin dhe ndërveprimin gjuhësor në kushtet e mungesës së dëmtimeve fizike të organit të dëgjimit.

Çrregullimet gjuhësore mund të vijnë edhe nga dëmtime të trurit gjatë aksidenteve, apo nga tumore a hemorragji në tru. Këto dëmtime manifestohen përmes çrregullimeve të të folurit, të zërit, gjuhës dhe të gjellitjes e deri në ndërprerje të proceseve gjuhësore, mungesë e kujtesës, vëmendjes, përpunimit të informacionit, arsytimit dhe zgjidhjes së problemeve. Jo rrallë, ato shoqërohen me hiperaktivitet, impulsivitet, mungesë të gjykimit social, mprehtësi të varfër, agresivitet dhe nevojë për t'u konfliktuar me të tjerët dhe për t'i dhunuar ata fizikisht.

Dëmtimet e komunikimit tek fëmijët me çrregullime gjuhësore janë të larmishme në varësi të vendit të dëmtimit të trurit. Në rastet më të rënda, (afazitë globale, të Vernicke apo Broca) vërehen mungesa totale e të folurit, mungesa totale e emrave, apo fraza pa kuptim ndërsa në rastet më të lehta, dëmtimet e të folurit dhe të kuptuarit janë minimale e manifestohen gjatë aktivizimit të proceseve të larta nervore (fëmijët nuk arrijnë të nxjerrin kuptimin nga pjesë të shkruara ose të dëgjuara, nuk kuptojnë metaforën, nuk operojnë me simbolet dhe abstraksionet, etj.). Përgjithësisht, fëmijët me çrregullime gjuhësore kanë fjalor të reduktuar, përdorim të paqëllimtë të fjalëve, mungesë të fjalëve lidhëse në të folur, stereotipi, pauza të gjata në të folur, të folur të zvargur apo të nxituar, perifrazim, gabime morfologjike, përsëritje të lodhshme të fjalëve dhe mendimeve. Në rastet kur tek fëmija është dëmtuar hemisfera e djathtë, dëmtimet gjuhësore nuk janë aq të shprehura, po gjithësesi janë të pranishme. Prindi, mësuesi, a psikologu mund të vërejnë se fëmija neglizhon pjesën e majtë të trupit apo sendet në anën e majtë, duron temperaturën apo dhimbjen. Ai kritikohet shpesh si i ngathët, se nuk kontrollon veten/emocionet, se nuk motivohet të qëndrojë në detyrë deri në fund dhe se nuk ka gjykim të shëndoshë në favor të vetes. Çrregullimet gjuhësore pengojnë në gjetjen e dallimeve mes formave, figurave apo shkronjave. Bile ngatërrojnë edhe të afërmit e tyre.

Dëmtimi i hemisferës së djathtë të trurit prek ndërveprimin gjuhësor. Të dëmtuarit në hemisferën e djathtë nuk arrijnë të kuptojnë mesazhet e nënkuptuara të gjuhës. Ata përpiqen të nxjerrin kuptimin e

gjuhës nga shuma e thjeshtë e fjalëve të përdorura, duke mos shkuar dot deri tek kuptimi i metaforës, humorit, alegorisë, idiomave, kërkesave jo të drejtpërdrejta, etj. Kur lexojnë, fëmijët me dëmtime të hemisferës së djathtë të trurit kanë vështirësi në dallimin e fjalëve, në kuptimin e informacionit kompleks, vështirësi në shoqërimin e fjalëve me figurat, vështirësi në identifikimin e pjesëve dhe krijimin e së tërës.

Në listën e dëmtimeve përfshihen edhe dëmtime të natyrës psikosociale si ndryshime të humorit, apatia, indiferenca dhe mohimi. Në mjedise të ngushta familjare, këta fëmijë e ndryshojnë në mënyrë drastike sjelljen, duke u bërë shumë të lodhshëm për familjarët dhe kujdestarët. Çrregullimet e humorit dhe veçanërisht depresioni besohet të bashkëshoqërojnë çrregullimet gjuhësore tek fëmijët me dëmtime të hemisferës së djathtë. Përkeqësime të tjera mund të jenë *hemipareza* (vështirësi në përdorimin e anësisë), *hemiplegjia* (paraliza e anësisë), *epilepsia* dhe mungesa e kontrollit mbi urinimin.

Besohet se gjuha është funksion i hemisferës së majtë, por këto dëmtime tregojnë se hemisfera e djathtë nuk është indiferente ndaj të zhvillimit gjuhësor e as minoritet gri.

## 2.b. Çrregullimet e të folurit Kodi: 315.39 (F80.0)

Kriteret e vlerësimit të çrregullimeve të të folurit përfshijnë:

**A-** Paaftësi në prodhimin e tingujve. Për shkak të mangësive (deficiteve) fonetike :

- i. ulet dëgjueshmëria e asaj që thotë fëmija
- ii. ulet kuptueshmëria e të folurit
- iii. pengohet komunikimi verbal te fëmija.

**B-** Paaftësi në artikulinin e fjalëve.(për shkak të mungesës së tyre):

- i. ulet efektiviteti i komunikimit
- ii. fëmija izolohet
- iii. performanca në shkollë mbetet shumë e varfër.

**C-** Shenjat e mësipërme duhet të jenë shfaqura në fëmijërinë e hershme

**D-** Vështirësitë dhe mangësitë (deficitet) e mësipërme nuk i atribuohen çrregullimeve kongjenitale ose aksidenteve si: dëmtimet cerebrale, shurdhëria, humbja e dëgjimit, dëmtimet traumatike të trurit apo kushteve të tjera neurologjike e mjekësore.

Nëse fëmija nuk arrin të prodhojë tinguj normalë dhe të artikulojë fjalë të kuptueshme nga dëgjuesi në të njëjtën kohë me bashkëmoshatarët besohet se ka çrregullime të zhvillimit fonologjik.

Çrregullimet fonologjike manifestohen në trajtën e paaftësisë për të kuptuar dhe prodhuar atë që kuptojnë dhe arrijnë të prodhojnë shumë mirë bashkëmoshatarët dhe të tjerët rrotull tij. Çrregullimet fonologjike mund të jenë të rënda, (kur ka shumë gabime në prodhimin e tingujve), por mund të jenë edhe të lehta, me fare pak gabime.

Fëmijët i mësojnë tingujt në mënyrë graduale përmes vetkorigjimit. Gabimet fonologjike janë sistematike. Pothuajse të gjithë fëmijët në një moshë të caktuar bëjnë gabime të tilla si zëvendësim të një tingulli me një tingull tjetër, reduktim të fjalëve, shkrirje të rrokjeve, bjerrje të bashkëtingëllores së pazëshme në fjalë, stopim, bllokim grykor apo buzor të tingujve, etj. Por përparimi drejt prodhimit të gjuhës në trajtën që e flasin të rriturit është konstant. Nëse fëmija luan nga kjo konstante zhvillimi, atëherë dyshohet se tek ai po fillon një çrregullim i të folurit. Një fëmijë me çrregullime të të folurit artikulon tinguj të izoluar, por kur i has në fjalë, nuk arrin t'i shqiptojë saktë.

Zhvillimi fonologjik ecën me të njëjtin ritëm me zhvillimin, e ndihmon atë. Fëmija rrit kompetencën dhe sigurinë në shumë drejtime. Por, nëse fëmija manifeston aftësi të limituar në të folur, ai fillon të manifestojë limitime në zhvillimin social, kognitiv e emocional.

Çrregullimet fonologjike në shkollarët e vegjël janë të shpeshta. Fëmija e manifeston vonesën fonologjike në shumë trajta. Në disa raste, ai flet si të ishte më i vogël në moshë (mund të përdorë rrokje të përsëritura për fjalë komplekse, p. sh. /ko-ko/ për /biskota/, /da-da/ për /dalim jashtë/. Një fëmijë i vonuar në aspektin fonologjik mund të vazhdojë të përsërisë rrokjet dhe tingujt për një kohë shumë më të gjatë. Në disa raste, prodhon fjalë në një mënyrë të pazakontë, duke e kufizuar shumë numrin e njerëzve që arrijnë të kuptojnë të folurit e tij.

Tek disa fëmijë ndodh një model tjetër gabimi. Edhe pse të rritur, ata nuk arrijnë të dallojnë fundin e fjalës së prodhuar nga të rriturit. P.sh., fjalët /dora/ dhe /dola/. Fëmija e dallon /r/ dhe /l/, por nuk është në gjendje t'i shqiptojë drejt sipas kontekstit.

Kur fëmija bën gabime në prodhimin e tingujve, të folurit mund të jetë i vështirë për t'u kuptuar. Fëmijët me çrregullime fonologjike, edhe pse përpiqen shumë të flasin, janë të pakuptueshëm.

Është gjë e shpeshtë që në moshën shkollare të dëgjohej ende një /r/ apo /s/ e shqiptuar jo drejtë. Kur ky është i vetmi problem, thuhet së fëmija ka një "problem të lehtë artikulimi" ose një "defekt rezidual". Defektet reziduale të të folurit janë mbeturina të gabimeve të fëmijërisë së hershme. Shembuj defektesh reziduale janë vështirësitë që hasin fëmijët deri në moshën 7-8 vjeçare me tingujt: /s/, /v/, /r/, /k/, etj. Megjithëse mungesa apo keqshqiptimi i tyre nuk ndërhyjnë në komunikim, defektet reziduale duhen riparuar pasi ato prekin autoportretin e fëmijës dhe marrëdhëniet me bashkëmoshatarët.

Megjithë dëshirën për të patur një përgjigje, e vërteta është se nuk ka ende dakoedësi bindëse mbi shkaktaret e çrregullimeve fonologjike. Shpesh, çrregullimet e të folurit kanë zanafillë kongjenitale. Bëhet fjalë për problemet kongjenitale të të dëgjuarit apo të prapambetjes mendore. Ato gjithmonë shoqërohen me çrregullime fonologjike. Jo rrallë herë çrregullimet fonologjike janë pasojë e infeksioneve të veshit.

Kërkimet e fundit mbi shkaktarët e çrregullimeve të të folurit po fokusohen në studimin e aftësisë së fëmijëve për të kontrolluar mekanizmat e të folurit. Kjo është një zonë shumë logjike kërkimi. Probleme të kontrollit mbi mekanizmat e të folurit vihen re tek të gjithë fëmijët me çrregullime nga më të lehtëta deri më të rëndat. Fëmijët me probleme fonologjike hasin vështirësi në koordinimin e muskulaturës së të folurit për të prodhuar tingujt e gjuhës.

Që të riprodhohet një tingull apo fjalë, ato duhen mbajtur mend. Perceptimi auditiv dhe procedimi gjuhësor është i vështirë deri në kufijtë e së pamundurës për disa fëmijë. Ata kuptojnë gjuhën mirë dhe duan të komunikojnë, por, në vend që të flasin me gojë, "flasin me sy", së paku për disa vite.

Në disa raste çrregullimi mund të ketë origjinë paralizën cerebrale, e cila është lehtë e identifikueshme nga shërbimi e neuropediasisë. Paraliza cerebrale pengon që muskujt të marrin tonin dhe kontrollin e domosdoshëm ekzekutiv.

Karakteristikat strukturore të mekanizmave të të folurit ndikojnë në rritjen e mundësisë për gabime në të folurit. P. sh. një fëmijë që ka dhëmbë të nxjerra shumë përpara, i ka kanalet e hundës të zëna apo ka një gjuhë të shkurtër a të trashë e ka të vështirë të artikulojë saktë.

Së fundi, janë një sërë shprehish motorike që fëmijët e vegjël duhet t'i perfeksionojnë deri në art që të mund t'i prodhojnë tingujt ashtu si duhet. Ato fitohen duke provuar të koordinohen muskujt në mënyra të ndryshme. Mesa duket, perfeksionimi i lëvizjes është art që duhet mësuar në një kohë kritike. Ata që nuk mundin të perfeksionojnë mënyrën e orkestrimit të lëvizjeve motorike në kohën

e duhur për shkak të patologjive të tjera (trajtimeve mjekësore, sëmundjeve, aksidenteve, traumave psikologjike), vuajnë pasojat e mangësive në të folur.

Dakordësia se fëmijët nuk arrijnë të artikulojnë “për shkak të problemeve me kontrollin e muskujve mbi mekanizmat e të folurit apo për shkak të dëmtimit të sistemit nervor qendror ose periferik” është konsensusi mbi shkaktarët e dëmtimeve fonologjike në këtë modul trajnimi. Zonat e prekura të këta fëmijë janë proceset e të folurit, proceset e frymëmarrjes, proceset e artikulimit, rezonimit, (shqiptimit të tingujve njeri pas tjetrit) dhe artikulimit.

## 2. c. Çrregullimi i pragmatizmit të komunikimit (komunikimit social) Kodi: 315.39 (F80.89)

### 2.c. Çrregullimi i pragmatizmit të komunikimit (komunikimit social) Kodi: 315.39 (F80.89)

Kriteret e vlerësimit të çrregullimit të komunikimit social:

- A.** Mangësi (deficite) të qëndrueshme në përdorimin social të komunikimit verbal dhe joverbal. Për shkak të tyre, fëmija manifeston shenjat e mëposhtme:
  1. Paaftësi në përdorimin e komunikimit për qëllime sociale,
  2. Paaftësi për të përshtatur komunikimin me kontekstin dhe nevojat e dëgjuesit,
  3. Vështirësi në ndjekjen e rregullave të bashkëbisedimit,
  4. Vështirësi në të kuptuarit e gjuhës metaforike.
- B.** Mangësia (deficiti) nuk lejon komunikimin funksional të fëmijës me të tjerët. Për këtë arsye, rritet izolimi social dhe pjesëmarrja, si dhe performanca në shkollë është e varfër.
- C.** Shenjat e mësipërme duhet të kenë filluar herët
- D.** Shenjat nuk duhet t’iu atribuohen faktorëve mjekësorë ose neurologjikë, varfërisë së gjuhës dhe nuk duhen shpjeguar me gjendje të tjera si autizmi apo prapambetja mendore.

Njerëzit e përdorin gjuhën për të shprehur nevojat e tyre. Përdorimi i gjuhës për qëllime përdorimi njihet si “pragmatizëm” gjuhësor. Mënyrën pragmatike të përdorimit të gjuhës fëmijët e mësojnë që herët, ndoshta linden bashkë me të, por disa nuk arrijnë ta zotërojnë. Ata nuk arrijnë të përdorin gjuhën për të shprehur nevojat dhe emocionet. As ta përshtatin atë me kushtet ku e përdorin gjuhën. Në vend që të përdorin gjuhën, ata përdorin sjellje të çuditshme, ndonjëherë të pakuptueshme edhe nga prindërit. Nëse arrijnë të flasin, repertori i tyre gjuhësor mbetet shumë i kufizuar. Ato i japin gjuhës një qëllim shumë instrumental. E përdorin telegrafisht për nevoja fare bazale si ushqimi apo lëvizja. Edhe kur zhvillojnë një fjalor relativisht më të pasur, ruhet stili telegrafik i të folurit. Në të folurin e tyre mungon prozodia (orkestrimi i të folurit me gjithë elementët e tij). Prozodia, që e bën të folurit të tingëllojë interesant dhe i rrjedhshëm është tërësisht e munguar tek ta, duke bërë që të folurit të mos variojë e të mos ndihmojë të kuptuarit e mendimeve dhe ndjenjave nga ana e bashkëbiseduesit. Mungesa e pragmatizmit dhe prozodisë varfërojnë komunikimin dhe izolojnë fëmijën.

Të folurit pa tonalitetet e shqipes, të folurit e zvargët, të avashtë, të folurit e paformë, i lodhshëm, i pakuptueshëm, bëhet shpejt i lodhshëm për fëmijën dhe për kujdestarët e mësuesit. Shpejt ata heqin dorë nga veshja e asaj që flasin me tonalitetet që natyrshëm prodhohen nga kuptimi, situata, emocioni që shoqëron të folurit. Nëse fëmija i manifeston këto shenja thuhet se ai ka çrregullime të pragmatizmit të të folurit.

Shkaktarët mbeten mistikë dhe përkojnë me shkaktarët e çrregullimeve të të folurit në përgjithësi.

## 2.d. Çrregullimi i mbajtjes së gojës Kodi: 315.35 (F80.81)

Kriteret e vlerësimit të mbajtjes së gojës:

**A.** Ndërprerje të rrjedhshmërisë normale të të folurit (disfluencë), vështirësi në shtrirjen e të folurit në kohë dhe mospërshtatje e cilësisë së të folurit me moshën. Fëmija me disfluencë manifeston shpesh një ose më shumë nga shenjat e mëposhtme:

- i. Përsëritje të tingujve dhe rrokjeve
- ii. Zgjatje të tingujve dhe rrokjeve, sidomos në fillim të fjalisë
- iii. Ndërprerje të fjalëve,
- iv. Ndërprerje të të folurit; i folur i bllokuar, i pazëshëm
- v. Zëvendësim të fjalëve me fjalë të tjera, ku i mbahet më pak goja
- vi. Tension muskolor gjatë të folurit
- vii. Përsëritje të fjalëve njërrrokëshe, sidomos në fillim të fjalisë.

**B.** Çrregullimi shkakton ankth nga e folura. Për shkak të tij:

- i. fëmija izolohet
- ii. nuk merr pjesë në aktivitete
- iii. ka performancë të dobët në shkollë.

**C.** Shenjat e mësipërme duhet të kenë filluar që në vitet e para të jetës.

**D.** Shenjat nuk i atribuohen çrregullimeve kongjenitale, aksidenteve apo dëmtimeve cerebrale (humbjes së dëgjimit, dëmtimeve traumatike të trurit apo kushteve të tjera neurologjike e mjekësore).

Rrjedhshmëria e të folurit përbën tiparin më të rëndësishëm të komunikimit. Jo thjesht për faktin se tingujt përçojnë kuptim me një ritëm të caktuar, por sepse ritmi është faktori që imponon kuptimin tek dëgjuesi dhe sjell mirëqenie mendore tek bashkëfolësit. Komunikimi realizohet përmes imponimit me anë të ritmit të të folurit, qartësisë së tingujve, pavarësisht shpejtësisë dhe lartësisë së zërit.

Po në disa fëmijë të folurit rezulton i ndërprerë. Kur të folurit ndërpritet në më shumë se 5% të masës së tij, besohet se fëmija ka çrregullimin e mbajtjes së gojës. Stërzgjatja e tingujve, heshtja, përsëritja e rrokjeve dhe fjalëve janë tiparet themelore të mbajtjes së gojës. Të folurit tek ta ka edhe tipare të tjera, po prania e vetëm dy prej tyre mjafton për të dhënë diagnozën: ndërprerja e rrjedhshmërisë dhe përpjekja kompensuese që bën fëmija.

### *Ndërprerja e rrjedhshmërisë*

Të folurit e fëmijës me çrregullim të mbajtjes së gojës mund të ndërpritet kudo në fjali, po më së shumti në fillim të saj, sidomos kur fjalia fillon me bashkëtingëllore buzore. Bashkëtingëllorja nistore përsëritet disa herë. Mbajtja e gojës tenton të ndodhë në pjesët kryesore të fjalisë, në tri fjalët e para të fjalisë, në rrokjet që kanë theks zanor, në fjalët dhe rrokjet që pasojnë, në fjalët që fillojnë me bashkëtingëllore, në pikat ku bashkohen bashkëtingëlloret fillestare të rrokjes me zanoret. Mbajtja e gojës nuk vërehet në fjalët që fillojnë me zanore.

Tipar tjetër i ndërprerjes së rrjedhshmërisë është bllokimi i të folurit. Për pas sekonda, fëmija ndërpret të folurit në mes pa shkak. Ajo që vjen më pas, është një i folur shumë i shpejtë, pa pauzat e nevojshme.

### *Kompensimi i mbajtjes së gojës*

Diagnoza e mbajtjes së gojës jepet kur fëmija përpos mungesës së rrjedhshmërisë së të folurit (disfluencës), manifeston edhe përpjekje plotësuese për të rifilluar të folurit. Të tilla janë lëvizje e grimasa të fytyrës, buzës, syve, vetullave, mjekrës, gjuhës, lëvizje të duarve që duken sikur ndihmojnë të dalë jashtë të folurit, si dhe lëvizje të trupit, kokës, qafës, këmbës, apo edhe të të gjithë trupit (chorea).

Mbajtja e gojës përkeqësohet gjatë viteve të para të shkollës, kohë kur zhvillimi gjuhësor dhe të folurit janë në kulmin e përsheptimit. Në fillimet e tyre, shenjat e mbajtjes së gojës shpesh janë episodike, vijnë dhe shkojnë, pa ndonjë shpjegim të dukshëm. Shumica e fëmijëve me këto episode nuk zhvillojnë ndonjë problem kronik të mbajtjes së gojës. Karakteristikat e të mbajtjes së gojës duan vite të zhvillohen. Zakonisht, ato nuk manifestohen që në fillim.

## 2.e. Çrregullime të paspecifikuara të komunikimit Kodi: 307.9 (F80.9)

Fëmija mund të vuajë edhe çrregullime të paspecifikuara të komunikimit. Më të zakonshmet janë stresi dhe ankthi nga e folura në mjedise ku pritet një përdorim normal i funksioneve gjuhësore të komunikimit.

Për të vendosur një diagnozë të tillë, psikologu e mësuesi verifikojnë nëse fëmija:

- i. Ka mbindjeshmëri ndaj tingujve
- ii. Irritohet nga tingujt që normalisht të tjerët i injorojnë: zhurma e frigoriferit, kondicionerit, ngrohësit, orës së murit, etj.,
- iii. Ka frikë/acarohet nga tingujt e fortë si kaseta e banjës, fshesa e korentit, alarmi i sobës, tharësja e flokëve etj.
- iv. Trembet nga zëri i lartë apo zhurmat e papritura
- v. Kërkon që të pranishmit të pushojnë së foluri, së kënduari, të mbyllin TV, etj.
- vi. Qan, dhe /ose mbulon veshët kur ka tingujt/zëra të lartë apo zhurma të papritura,
- vii. Refuzon të shkojë në kinema, stadium, koncert, qendra tregtare, etj.
- viii. Dallon se dikush po afrohet edhe kur të tjerët nuk janë në gjendje ta bëjnë këtë.

Çrregullimet e paspecifikuara të komunikimit kryesisht ndodhin në praninë e një diagnoze tjetër të çrregullimeve neurozhvillimore, kryesisht të spektrit të autizmit apo të paaftësisë mendore. Fëmijët me çrregullime të paspecifikuara kanë sjellje të çuditshme. Ata reagojnë në situata ku të tjerët nuk vërejnë stimuj ndaj të cilëve duhet të reagojnë. Fëmijët me çrregullime të tilla shpesh mbulojnë veshët me të dyja duart, klithin pa ndonjë shkak të dukshëm, injorojnë ndodhitë dhe personat rrotull, obsesohen pas një objekti, personi a lëvizjeje, mungesa e të cilëve iu jep ankth të shtuar. Ata kanë mbindjeshmëri ndaj tingujve, por nuk arrijnë t'u japin kuptim rreziqeve që mund të vijnë nga sinjale të caktuara, si sirena e trenit, buria e makinës, zilja e derës apo sobës. Ata injorojnë përgjithësisht zërin njerëzor, por arrijnë të krijojnë reagime ndaj tonalitetëve të caktuara sidomos të kujdestarëve të tyre. Më shumë se sa komunikimi, individë me çrregullime të tilla preferojnë rutinat dhe mjediset e strukturuar. Ato bëhen rregullatore të jetës së tyre.

## 3. ÇRREGULLIMET E SPEKTRIT TË AUTIZMIT Kodi: 299.00 (F84.0)

Kriteret e vlerësimit të çrregullimeve të spektrit të autizmit përfshijnë:

- A.** Mangësi (deficite) të qëndrueshme në komunikimin dhe ndërveprimin social. Fëmija manifeston shenjat e mëposhtme, pavarësisht kontekstit:
  - i. Mangësi (deficite) të reciprocitetit social e emocional,
  - ii. Mangësi (deficite) në komunikimin joverbal (gjuha e trupit, kontakti me sy, empatia),
  - iii. Mangësi (deficite) në zhvillimin, ruajtjen dhe të kuptuarit e marrëdhënieve (mospërshtatja e sjelljes me mjedisin, mungesa e lojës imagjinare, mungesa e interesit për bashkëmoshatarët, të afërmit dhe familjarët).  
(Për sa më sipër, përcaktohet ashpërsia e simptomave sipas Tabelës Nr. 1).

**B.** Sjellje përsëritëse, interesa dhe veprimtari të kufizuara. Fëmija manifeston:

- i. Lëvizje motore stereotipike, përdorim stereotipik të gjuhës dhe të të folurit apo përdorimit të objekteve
  - ii. Këmbëngulja tek e njëjta, mungesa e tolerancës, preferencat për rutinat, modele rituale të sjelljeve verbale e joverbale (stres i madh për ndryshime të vogla, vështirësi në kalimin nga një veprimtari në një tjetër, modele fikse të të menduarit, rituale fikse të përshëndetjes, preferenca ekstreme (e njëjta rrugë, i njëjti ushqim, e njëjta veshje, e njëjta lodër).
  - iii. Interesa shumë të kufizuara dhe të fiksuara në një fushë, të shprehura me një intensitet të lartë dhe përkushtim patologjik (atashim problematik me një person ose objekt, preokupim dhe interesa të tepërta në një fushë ose për objekte të çuditshme)
  - iv. Hipo- ose hiperaktivitet, reagim i pazakontë ndaj stimujve, interesa të pazakonta ndaj faktorëve stresues dhe mjedisit (indiferencë ndaj vuajtjes të të tjerët, pandjeshmëri ndaj dhimbjes, temperaturës, reagime të çuditshme ndaj zhurmave, zërave, sipërfaqeve, veshjeve, reagim i shtuar ndaj ngacmuesve të papërfillshëm për të tjerët, si: ndryshime të vogla në rutinë, ushqim, veshje, mbindjeshmëri ndaj erërave, apo personave të caktuar, interes pas dritave, lëvizjeve ritmike dhe objekteve që lëvizin).
- (Për sa me sipër, specifikohet ashpërsia e simptomave sipas Tabelës 1).

**C.** Simptomat duhet të jenë të dukshme që herët në fëmijëri.

**D.** Simptomat duhet të kenë dëmtuar konsiderueshëm fusha të ndryshme të funksionimit të individit si: fushat sociale, të veprimit, shkollore, emocionale, etj.,

**E.** Simptomat nuk shpjegohen me paaftësinë mendore apo paaftësinë globale intelektuale. (Shpesh herë autizmi dhe paaftësia mendore gjenden së bashku).

Diagnoza e autizmit mund të gjendet bashkë më çrregullime të tjera:

- i. Autizëm me /pa çrregullim të zhvillimit mendor
- ii. Autizëm me/pa çrregullim gjuhësor
- iii. Autizëm me gjendje të cilësuar shëndetësore
- iv. Autizëm me shtrat gjenetik
- v. Autizëm me ndikim mjedisor
- vi. Autizëm me katatoni: kodi 293.89 (F06.1)

Në bazë të gjykimit mbi ashpërsinë e shfaqjes së simptomave të grupit **A** dhe grupit **B**, çrregullimet e spektrit të autizmit klasifikohen si:

**Autizëm, niveli I:** Fëmija kërkon trajtim të veçantë, por mund të qëndrojë në klasë normale gjithëpërfshirëse. Ai mund të ketë Plan Edukativ Individual ose mund të ecë më programin e klasës së tij.

**Autizëm, niveli II:** Fëmija kërkon trajtim profesional. Ai ka Plan Edukativ Individual dhe, sipas nevojës, edhe Plan të Modifikimit të Sjelljes. Ai vendoset në klasë të arsimit special dhe mund të ndjekë një pjesë të orëve mësimore në një klasë të rregullt.

**Autizëm, niveli III:** Fëmija ka nevojë për shumë trajtim të veçantë. Ai vendoset në klasë të arsimit special, ka domosdoshmërisht Plan Edukativ Individual (PEI) dhe Plan të Koordinimit të Shërbimeve (PKSH) (shërbimeve psikologjike, terapeutike, sociale, mjekësore, ligjore, financiare, etj.). Nëse merr mjekime nga mjeku psikiatër, fëmija ka edhe Plan të Monitorimit dhe Modifikimit të Sjelljes (PMMS). Autizmi është çrregullim neurozhvillimor që karakterizohet nga dëmtimi i ndërveprimit social dhe komunikimit dhe që shpesh shoqërohet me sfida kognitive, kufizim dhe/ose përsëritje kompulsive të sjelljeve të pakuptimta. Këto shenja shfaqen te fëmija që para moshës tre vjeç, por diagnoza formale dhe trajtimi sistematik fillojnë si rregull pas kësaj moshe. Autizmi prek përpunimin e gjithë informacionit dhe domethënies së tij sociale.

Çrregullimet e spektrit të autizmit manifestohen si dëmtim në ndërveprimin social, dëmtim në komunikim, kufizim të interesave dhe shtim të sjelljeve repetitive (të përsëritura).

Deficitet sociale dallojnë autizmin nga çrregullime të tjera zhvillimore. Zhvillimi i pazakontë social bëhet i dukshëm në fillim të fëmijërisë. Fëmijët me autizëm kanë dëmtime sociale dhe nuk fitojnë perspektivën e tjetrit, as ndjejnë si të tjerët. Fëmijët me autizëm nuk reagojnë ndaj stimujve sociale dhe as respektojnë normat sociale. Ata nuk kanë mirëkuptim social, nuk bashkëveprojnë me të tjerët spontanisht, nuk imitojnë dhe as u përgjigjen emocioneve të të tjerëve.

Fëmijët me autizëm nuk zhvillojnë interesa. Ata nuk e ndajnë veten nga të tjerët, as të tjerët nga vetja. Ata kanë mungesë të theksuara interesash, mungesë përqendrimi në aktivitete, mungesë interesi për larminë, atashim në një program TV, objekt apo ritual. Ata obsesohen me objekte që lëvizin ose bartin lëvizje, po edhe ato nuk i njohin e as i përdorin për qëllime të ndryshme.

Fëmijët me autizëm nuk arrijnë të komunikojnë qartë nevojat e tyre. Ata mësojnë me vështirësi sjellje të thjeshta dhe kanë vështirësi të transferojnë të mësuarën në mjedise të reja. Të folurit e tyre ka trajtën e *ekolalisë* ose *afazisë globale*. Në vend të gjuhës, ata përdorin sjelljen, sidomos për të shprehur nevojat bazë.

Fëmijët me autizëm shfaqin forma të ndryshme të sjelljeve përsëritëse, si: tundja e duarve, lëshimi i tingujve, lëkundja e trupit. Ata karakterizohen nga sjellje kompulsive si ndjekja e rreptë e rregullave apo rendit. Ata janë të ngurtë në rutinat e tyre.

Shumë prej fëmijëve të diagnostikuar me autizëm kanë ndjeshmëri të shtuar ndaj lëvizjes, janë rezistentë ndaj ndryshimit, këmbëngulës, të pashpjeguar në natyrën e tyre, të atashuar me objekte sidomos kur zhvendosjen/lëvizin nga një vend në tjetrin. Ata i duan ritualet. Kërkojnë modele të njëjta të aktiviteteve të përditshme, menu fikse, rroba të preferuara, lodra të preferuara. Një pjesë e fëmijëve autikë kanë sjellje vetëlënduese: pickojnë lëkurën, godasin kokë, fytyrën, përplasjin trupin, etj.

Fëmija me autizëm jo vetëm që kryen lëvizjeve stereotipike, mund të tolerojë dhimbjen e madhe, por qan shumë kur vritet sadopak. Mësuesi, prindi e psikologu shikojnë jo vetëm për praninë e lëvizjeve tipike, kryesisht të dorës, po edhe të kërcimit të trupit përpara, të qëndrimit në majë të gishtave, të prekjes së fytyrës ose flokëve. Një pikë shiu, uji i dushit mbi lëkurë, era e parfumit, kremi në lëkurë mund të jenë tortura për fëmijën dhe mund të prodhojnë reagime negative dhe shmangie nga angazhimet. At trembet nga lëvizjet e befta, bezdiset nga tegeli në rroba apo çorape, refuzon të ecë në rërë ose z bathur, qëndron në majë të gishtave. Ka shije eksese (preferon shumë të ëmblat, të thartat, djegëset ose të kripurat me tepri). Një pjesë e tyre kanë dëshirë të rrotullohen në vend, të hidhen dhe të kërcëjnë pa kuptim, të ecin duke u hedhur, të jenë gjithmonë në lëvizje.

Në disa raste, fëmijët me çrregullim të lëvizjeve stereotipike mund të mos jenë në gjendje të identifikojnë pjesët e trupit, mund të kenë frikë nga errësira, janë të çrregullt, nuk dinë ku i kanë sendet personale, kanë vështirësi të tregojë karakteristikat fizike (formën, madhësinë, cilësitë, temperaturën, peshën, etj.) të figurave dhe objekteve. Një pjesë e tyre nuk kanë fare tension muskolor, lodhen shpejtë, e kanë të vështirë të kthejnë dorezën e derës, të hapin kapakët e tenxheres, dritaren, të mbajnë librin. Gabimisht, këta fëmijë mund të konsiderohen “dembelë”, “hileqarë”, “të painteresuar”.

Nuk ka ende një shkak të qartë për autizmin, por ka shumë shkaktarë të supozuar të tij. Diagnostikimi i tij bëhet duke komunikuar me fëmijën, duke vrojtuar ndërveprimin social, duke ndjekur cilësinë e angazhimit në aktivitete dhe duke analizuar format e shprehjes së interesave.

Meqenëse shumë nga sjelljet e repertorit të autizmit janë të njëjta/ngjashme me sjellje të disa çrregullime të tjera (PKU), rekomandohet që fëmija të bëjë testet e rekomanduara nga mjeku me qëllim që të përjashtohen diagnoza të mundshme mjekësore.



## 4. CRREGULLIMET E INHIBIMIT (çrregullim i lehtë, i moderuar, i rëndë)

**4.a. ADHD (tipi i çrregullimit të vëmendjes me hiperaktivitet, niveli i lehtë, i moderuar, i rëndë) Kodi: 314.01 (F90.2)**

**4.b. ADD (tipi i çrregullimit të vëmendjes, niveli: i lehtë i moderuar, i rëndë) Kodi: 314.00 (F90.0)**

**4.c. HD (tipi i çrregullimit të hiperaktivitetit, niveli: i lehtë i moderuar, i rëndë) Kodi: 314.01 (F90.1)**

Fëmija me çrregullimet e inhibimit karakterizohet nga paaftësia për të ndaluar, bllokuar një veprimtari me qëllim nisjen e një veprimtarie të re. Kriteret e diagnostikimit të fëmijës me çrregullime të inhibimit përfshijnë:

**A.** Prani e përhershme e pavëmendjes, e hiperaktivitetit, impulsivitetit të cilat pengojnë funksionimin dhe zhvillimin. Fëmija manifeston:

**1.** Mungesë të vëmendjes (6 nga shenjat e mëposhtme duhet të jenë të pranishme për, të paktën, 6 muaj):

- i. Nuk arrin të përqendrohet (bën gabime nga pavëmendja në detyra)
- ii. Nuk e ruan vëmendjen në detyrë ose lojë
- iii. Nuk dëgjon kur i drejtohen atij/asaj drejtpërdrejt
- iv. Nuk ndjek dot udhëzimet
- v. Nuk i mbaron dot detyrat, (shpesh fokusohet në gjëra anësore)
- vi. Ka vështirësi në organizmin e vogël për të kryer detyrat/veprimtaritë
- vii. Shmanget nga detyra e veprimtari që kërkojnë përpjekje mendore
- viii. Humbet sendet e veta
- ix. Tërhiqet lehtësisht nga stimujt e jashtëm.

**2.** Prani e hiperaktivitetit dhe impulsivitetit (6 nga shenjat e mëposhtme duhet të kenë qenë të pranishme, të paktën, për 6 muaj):

- i. Lëviz gjymtyrët pa qëllim
- ii. Lëviz në vend pa pushim
- iii. Ngrihet nga vendi i punës pa ndonjë qëllim
- iv. Vrapon, në vend që të ecë
- v. Nuk është i aftë të luajë në qetësi një lojë deri në fund
- vi. Është gjithmonë në lëvizje
- vii. Flet shumë
- viii. E jep përgjigjen pa dëgjuar pyetjen
- ix. Ka vështirësi të presë radhën
- x. Ndërpret të tjerët.

**B.** Shenjat e hiperaktivitetit dhe impulsivitetit janë shfaqur para moshës 12 vjeçare.

**C.** Simptomat ndikojnë me cilësinë e punës në shkollë, me përfshirjen në detyra e veprimtari dhe performancën në tërësi.

**D.** Simptomat nuk shpjegohen me prapambetjen mendore.

Çrregullimi i vëmendjes me ose pa hiperaktivitet (ADD, HD, ADHD) njihet si një nga çrregullimet më të shpeshta neurozhvillimore tek fëmijët. Grupi i çrregullimeve të inhibimit karakterizohet prej vëmendjes së varfër, impulsivitetit dhe hiperaktivitetit. Këto karakteristika mund të manifestohen veçmas ose së toku.

Fëmijët me ADD, HD, ADHD veprojnë pa u menduar. Ata kanë vështirësi të përqendrohen: e kuptojnë çfarë u kërkohet, por e kanë vështirë ta realizojnë, pasi nuk mund të përqendrohen në detyrë, nuk u kushtojnë vëmendje dhe as janë të kujdesshëm ndaj detajeve të detyrës që u jepet.

Mësuesi, prindi dhe psikologu shikojnë edhe për praninë e karakteristikave të tjera. Fëmijët me çrregullime të inhibimit mund të dallohen nga vështirësia për të pozicionuar trupin sipas rrethanave dhe detyrës, lëvizjet i kanë e shpeshta dhe të paqëllimta, kanë vështirësi në përdorimin e dorës lirshëm (shtrëngojnë fort lapsin, shkrimin e kanë tipikisht të vogël), preferojnë të kenë rroba të shtrënguara (xhupin, shallin e kapuçin i duan pas trupit).

Ata kanë nevojë për afrimetet fizik, përqafojnë prindin, mësuesin/en, shokët. U pëlqejnë zhurma, zëri i lartë i TV; vetë flasin me zë të lartë, por nuk dallojnë dot nga vjen zëri. Flasin me vete me zë të lartë kur bëjnë detyrat apo dushin. Bëjnë shumë pyetje të tipit “Çfarë?” dhe mund të mos presin ose ta harrojnë përgjigjen.

Fëmijët që kanë të kombinuar çrregullimin e mungesës së vëmendjes me hiperaktivitetin janë më të shumtë. Po çrregullimi i mungesës së vëmendjes ekziston edhe i ndarë nga çrregullimi i hiperaktivitetit. Shenjat e mëposhtme përshkruajnë çrregullimet veçmas:

#### **Çrregullimi mungesës e vëmendjes (ADD):**

Fëmija me ADD karakterizohet nga karakteristikat e mëposhtme në sjellje:

- Ka vështirësi në kapjen e detajeve
- Bën gabime të pakujdesshme në shkollë, punë apo veprimtari të tjera.
- Ka vështirësi në kryerjen e detyrave apo veprimtarive;
- Shpesh duket se nuk dëgjon, edhe pse i flitet në mënyrë direkte;
- Shpesh injoron udhëzimet dhe nuk arrin të përfundojë detyrat, punët;
- E ka të vështirë organizimin e detyrave dhe të aktiviteteve;
- Në të shumtën e rasteve shmanget, nuk i pëlqen ose nuk është i gatshëm për t'u angazhuar në detyra, të cilat kërkojnë përpjekje mendore;
- Humbet gjërat e nevojshme për detyra apo veprimtari;
- Hutohet lehtë nga stimuj të veçantë;
- Harrohet në aktivitetet e përditshme.

#### **Çrregullim i vëmendjes me hiperaktivitet (ADHD):**

Fëmija me ADHD dallohet nga karakteristikat e mëposhtme në sjellje:

- Në të shumtën e rasteve bën lëvizje të pakontrolluara, lëviz duar e këmbë, përpëlitet, lëviz, vrapon, rrotullohet pa kuptim,
- Nuk ka kontroll mbi emocionet e veta,
- E ka të vështirë të luajë ose të angazhohet në aktivitete,
- Është gjithmonë në lëvizje, sikur të ketë hipur mbi një motor që nuk ndalet,
- Flet shumë, nuk kontrollon dialogun, angazhohet në biseda që ngjajnë më tepër si monolog.

#### **Çrregullimi i hiperaktivitetit (HD):**

Fëmija me çrregullim të hiperaktivitetit (HD) dallohet nga karakteristikat e mëposhtme në sjellje:

- Ngutet në dhënien e përgjigjeve,
- Nuk ka durim të presë,
- Nuk pret radhën në të folur,
- Ndërhyn në bisedat e të tjerëve.
- Ka temperament shpërthyes

ADD, HD dhe ADHD raportohen të shoqërohen shpesh me simptoma të ankthit dhe depresionit.

Tiparet që i dallojnë fëmijët me çrregullime të inhibimit nga fëmijët e tjerë përfshijnë:

- *Paaftësi për të frenuar sjelljen, për të kontrolluar impulset*  
Fëmijët me ADHD janë të paaftë për të ndaluar në kohë, për të menduar përpara veprimit, për të pritur radhën. Ata tentojnë të mos jenë në gjendje të respektojnë rregullat, të bashkëbisedojnë me të tjerët, të evitojnë arrogancën dhe nevojën për të dominuar të tjerët. Ata nuk tonizojnë sjelljen dhe emocionet përshtat rrethanave.
- *Kënaqësi e shtuar nga aktivitetet*  
Fëmijët me ADHD e stërzgjasin nevojën për kënaqësi (p.sh, vazhdojnë të qeshin kur të gjithë kanë pushuar, vazhdojnë të ngacmojnë të tjerët, edhe pse u kërkohet të pushojnë, torturojnë zogjtë, macet, qentë për kënaqësinë e tyre).
- *Paaftësi për të ruajtur rregullin në kryerjen e detyrave/zgjidhjen e situatave*  
Fëmijët me ADHD janë shumë nervoz dhe shqetësohen lehtë. Ata kanë lëvizje të tepruara, të panevojshme. Shpesh kritikohen për veprime të palidhura me situatën si përdredhja e këmbëve, hedhja e objekteve, lëkundja e karriges, zhvendosja e trupit në pozicionin të papërshtatshëm për detyrën. Ata mërzhiten shpejt, nuk kanë durim, nuk ndjejnë kënaqësi në kryerjen e një detyre sidomos atyre që kanë një protokoll fiks zgjidhjeje.
- *Paaftësi për të përqendruar vëmendjen në detyrë*  
Ata mërzhiten nga detyrat, i konsiderojnë të mërzhitshme dhe shpesh kalojnë nga një detyrë e papërfunduar tek tjetra. Ata e humbin përqendrimin pikërisht atëherë kur duhet të jenë më të vëmendshëm.
- *Paaftësi për të punuar me kujtesën e punës*  
Ata etiketohen si “harraqë”, pasi nuk mbajnë mend informacione të rëndësishme.
- *Paaftësi për t’u organizuar*  
Fëmijët me ADHD janë të çorganizuar, humbasin qëllimin, maturinë në planifikimin dhe organizimin e vetes dhe punëve. Ata nuk e përdorin kohën mirë, bëhen vonë, kanë probleme me menaxhimin e vetes dhe probleme me organizimin e aktiviteteve rutinë.
- *Paaftësi për t’u vetëmonitoruar*  
Kohët e fundit është provuar se fëmijët me ADHD janë të vonuar në zhvillimin e gjuhës së brendshme, e për pasojë edhe në zhvillimin e shprehive metakognitive.
- *Paaftësi në frenimin e reagimeve të shtuara emocionale*  
Ata shprehin çdo gjë që ndiejnë dhe kanë pak kontroll mbi emocionet, sidomos në publik. Nevoja për të tejzgjatur kënaqësinë është e pranishme në çdo situatë.
- *Paaftësi për të zgjidhur problemet*  
Fëmijët me ADHD nuk janë flëksibël e inteligjentë në ndjekjen e qëllimeve, sidomos atyre afatgjata. Ata i harrojnë premtimet lehtë.
- *Paaftësi ekzekutive*  
Fëmijët me ADHD mund të jenë të vonuar në zhvillimin e funksioneve ekzekutive.

## 5. ÇRREGULLIME SPECIFIKETË TË NXËNIT (të lehta, të moderuara, të rënda)

### 5.a. Çrregullimet në lexim (disleksi) Kodi: 315.00 (F81.0)

### 5.b. Çrregullimet në shkrim Kodi: 315.2 (F81.81)

### 5.c. Çrregullimet në matematike Kodi: 315.1 (F81.2)

Çrregullimet specifike të të nxënësve shfaqen te një kategori fëmijësh kur shkojnë në shkollë. Ata nuk kanë mangësi (deficite) të dukshme, por kur fillojnë shkollën hasin vështirësi të mëdha në lexim, shkrim dhe matematikë. Ato klasifikohen në: çrregullime në lexim, çrregullime në shkrim dhe çrregullime në matematikë.

Kriteret për diagnostikimin e nxënësve me çrregullime specifike të të nxënësve:

- A.** Vështirësi në nxënien dhe përdorimin e shprehive akademike, të shprehura përmes mungesës së shprehive të mëposhtme për një periudhë 6 mujore
  - i. lexon me gabime, bën shumë përpjekje për të lexuar, është i ngadaltë në të lexuar
  - ii. vështirësi për të nxjerrë kuptim nga pjesa e lexuar
  - iii. vështirësi në të shkruar
  - iv. vështirësi të shprehet me shkrim,
  - v. vështirësi të mësojë numrin dhe llogaritjet
  - vi. vështirësi në arsyetimin matematikor.
- B.** Shprehitë e prekura janë shumë më poshtë nga të bashkëmoshatarëve dhe prekin të nxënësve dhe arritjet,
- C.** Çrregullimet specifike të të nxënësve në matematikë shfaqen tipikisht në moshë shkollore.
- D.** Çrregullimet nuk shpjegohen me prapambetje mendore, vështirësi të të parit ose të dëgjuarit, gjuhën e dytë apo papërshtatshmërinë e kushteve të shkollës.

### 5. a. Çrregullimet në lexim (disleksia) Kodi: 315.00 (F81.0)

Vështirësia në të lexuar quhet “disleksi”. Çrregullimi i disleksisë karakterizohet nga paaftësia për të dalluar dhe për të njohur shkronjat dhe fjalët, nga një lexim i ngadaltë, i pasaktë, i papërshtatshëm, si dhe nga paaftësia për të kuptuar pjesën e lexuar në kushtet e mungesës së dëmtimit të inteligjencës apo të deficiteve sensorë.

Ky çrregullim mund të shfaqet vetëm ose me çrregullime të tjera si çrregullimet e të shkruarit (disgrafia), çrregullimet matematikore (diskalkulia) apo çrregullimet e të folurit.

Çrregullimi shfaqet qartë me vajtjen e fëmijës në shkollë. Shenjat gjithmonë lidhen me pamundësinë për të njohur shkronjat, fjalët, për t'i lexuar rrjedhshëm, për të kuptuar se çfarë lexohet. Në disa raste, fëmija mund të mos arrijë të mësojë as edhe se ku fillohet leximi i një fjale a fjalie. Ai mund ta nisë leximin nga mesi i fjalës, apo fjalinë nga fjala e mesit a e fundit, nuk ndjek dot rreshtin e shpesh i kapërcen rreshtat pasi nuk nje shenjat e pikësimit.

Fëmijët disleksikë përgjithësisht i mbajnë librat shumë afër fytyrës, ankohen nëse drita u bie mbi libër, ngrenë kokën shpesh gjatë leximit dhe hedhin shikimin larg faqes së librit. Ata e shikojnë faqen e librit me një sy dhe ankohen se u “zhduken” ose “u lëvizin” shkronjat. Ndonjëherë u ndodh t'i shikojnë më mirë shkronjat kur sfondi i shkronjave është me ngjyrë (jo i bardhë). Të lexuarit e tyre është plot gabime: gabojnë në njohjen e shkronjave, ngatërrojnë shkronja të ngjashme, pengohen dhe rifillojnë disa herë të lexuarit nga e para, fërkojnë sytë, ankohen se nuk kuptojnë atë që lexojnë dhe, jo

rrallëherë, ankohen se kanë dhimbje koke. Ata dukshëm nuk i lëvizin sytë natyrshëm horizontalisht përgjatë rreshtave. Përkundrazi, sytë e tyre lëvizin lart e poshtë, ose për të parë përgjatë rreshtit; u duhet të lëvizin kokën dhe të ndjekin me gisht atë që lexojnë.

Shumë shpejt, fëmija fillon të ndjejë ankth, turp, inat ndaj vetes dhe mësueses, frustrim të vazhduar, e deri në zemërim konstant, vetvlerësim të ulët dhe depresion.

### **5. b. Çrregullimet në shkrim (disgrafia) Kodi: 315. 2 (F81. 81)**

Fjalët janë mjeti kryesor i komunikimit Me to njerëzit këmbëjnë çfarë duan, çfarë mendojnë, si ndihen. Dhe këtë e bëjnë shpejt e pa mundim. Por kur duhet të shkruhen, fjalët bëhen të rënda, të vështira, të ngadalta për shumë fëmijë. Besohet se, që të “ndodhë” shkrimi, fëmija duhet të transferojë mënyrën dëgjimore të tingujve (atë që dëgjon) në një mënyrë të printuar. Edhe pse sistemi tingullor në moshën shkollare njihet, fëmijët kanë vështirësi në transferimin e tij në një sistem të ngurtë shkrimi. Vështirësia është normale dhe e pritshme. Fëmijët vazhdojnë akoma të zhvillohen dhe perfeksionojnë sistemin fonologjik. E kjo ndoshta do të zgjasë deri në hyrje të adoleshencës.

Të shkruarit është arritja më e sofistikuar dhe komplekse e sistemit gjuhësor. Fëmija kur shkruan mban në mendje atë që do të shkruajë dhe duhet ta vargëzojë në pjesë, sipas shpejtësisë së shkrimit. Ndërkohë që shkruan fjalët apo fjalitë i duhet të kujtojë edhe formën e saktë të secilës shkronjë. Paralelisht, duhet të përdorë shprehje vizuale dhe motorike si dhe të integrojë lëvizjet dorë-sy, të zotërojë drejtshkrimin e kaligrafinë, të shkruajë lexueshëm, të njohë rregullat e të shkruarit, si dhe plot e plot strategji të tjera. Disa fëmijë nuk i kanë këto shprehje. Të shkruarit e tyre ka prirje të jetë plot gabime, i çuditshëm në paraqitje dhe shpeshherë thuajse i palexueshëm.

Fëmijët me disgrafi nuk kanë domosdoshmërisht çrregullime gjuhësore. Çrregullimi i tyre shfaqet kur u duhet të transferojnë fonologjinë (tingujt) në grafi (shkronja). Fëmijët me disgrafi nuk e rrokin dot këtë proces transferimi. Shkrimi i tyre karakterizohet nga përmbysja e shkronjave, shkruarja e fjalës duke filluar nga fundi, shkruarja e shkronjave pa respektuar rreshtat, shkëputja e fjalëve në mes, etj. Vështirësia për të vizualizuar shkronjat apo vështirësia me memorien dëgjimore pengon për radhitjen e tyre. Një pjesë e fëmijëve me disleksi nuk i mbajnë mend tingujt të radhitur në fjalë e disa të tjerë kanë vështirësi me kujtesën motorike. Kjo vështirësi mund të zgjasë gjithë jetën.

Shkrimi i parregullt, jo uniform nuk do të thotë që kemi të bëjmë me disgrafi. Ekzistojnë disa sjellje paralajmëruese për disgrafi të mundshme, si: fëmija e shtrëngon lapsin shumë, tensionon gjithë trupin, lëviz krahun bashkë me shpatullën kur shkruan, eviton detyrat me shkrim, lodhet shpejt kur shkruan, i shqipton me zë të lartë fjalët që shkruan, lë shumë fjalë të papërfunduara ose i harron, vështron dorën kur shkruan. Në pjesën e shkruar nga një fëmijë me disgrafi mungon pikëzimi në të shkruar, ka përmbysje të fjalëve dhe numrave, ka mungesë rrokjesh, ka gabime në prapashtesa, ka mungesë uniformiteti: përzierje të shkronjave të shtypit me ato të dorës, madhësi dhe forma të parregullta, pjerrësi të alternuar, injorim të vizimeve në fletë, pozicione të çuditshme të dorës, etj.

Kur vlerësohet fëmija për disgrafi, përgjithësisht shikohen aftësitë e motorikës fine për integrimin vizual-motorik (aftësia për të integruar dorën dhe syrin së bashku), dallimi i formave, shkronjave dhe numrave, orientimi i shkrimit, aftësia për të njohur shkronjat dhe përpekja për të shkruar.

### **5. c. Çrregullimet në matematikë (diskalkulia) Kodi: 315. 1 (F81. 2)**

Çrregullimi matematikor ose diskalkulia është një nga çrregullimet specifike të të nxënit. Aftësitë matematikore të fëmijës me diskalkuli janë dukshëm nën nivelin e pritur të moshës. Fëmijët me diskalkuli kanë vështirësi në njohjen e numrave, vështirësi për të numëruar apo kopjuar numrat, kujtesë të varfër të numrave, vështirësi për të mësuar veprime matematikore si mbledhje, zbritje, shumëzim e pjesëtim. Këta fëmijë shmangin lojërat që kërkojnë strategji në përdorimin e numrave,

nuk arrijnë të mësojnë fjalorin e matematikës, shfaqin vështirësi në matje, në mësimin e tabelës së shumëzimit, në organizimin e veprimeve numerike. Ata i ngatërrojnë numrat p.sh., /51/ dhe /15/. Edhe kur arrijnë të kuptojnë një drejtim të kryerjes se veprimeve matematikore, nuk arrijnë të realizojnë të anasjelltën, kryerjen e ushtrimit në anë të kundërt ( $3+2=5$ ;  $5-3=2$ ). Ata ndeshin vështirësi të mëdha kur punojnë me bashkësitë, përqindjet, thyesat, mesataret, kur duhet të mësojnë datën apo orën, këmbimin e parave, orientimin në kohë, etj.

Fëmijët me çrregullimin e diskalkulisë përdorin gishtat për të llogaritur, nuk kryejnë llogaritje të thjeshta, nuk automatizojnë veprime të thjeshta matematikore, punojnë ngadalë dhe bëjnë gabime në llogaritje. Ata kanë vështirësi vizualo-hapësinore, ngatërrojnë kolonat, rreshtat, nuk rendisin dot numrat sipas radhës, kanë vështirësi në planifikimin e zgjidhjes së problemeve.

Të parë më me kujdes, vërehet se këta fëmijë kanë deficite procedurale, deficite në kujtesën semantike, deficite vizualo-hapësinore dhe deficite në njohjen e kuptimit të numrit dhe veprimeve matematikore. Diskalkulia shpeshherë shoqërohet me çrregullime të tjera të të nxënit si me disleksinë, disgrafinë, dispraksia, ADHD.

Bashkë me çrregullimin matematikor, shpesh shfaqen edhe probleme emocionale, në sjellje, apo tërheqje sociale. Fëmijët me çrregullime në matematikë shfaqin më shumë probleme sociale në krahasim me fëmijët e tjerë me çrregullime neurozhvillimore.

## 6. ÇRREGULLIMET MOTORE Kodi 315.4 (F82)

Kriteret e vlerësimit për praninë e çrregullimeve motore te fëmija përfshijnë karakteristika si:

- A.** Përfitimi dhe ekzekutimi i lëvizjeve është i papërshtatshëm për moshën (është i avashtë, i pasaktë, nuk kap, nuk mban)
- B.** Çrregullimi i lëvizjes pengon të nxënit e shprehive të reja
- C.** Çrregullimi ka filluar herët
- D.** Çrregullimi nuk shpjegohet me paaftësinë mendore, çrregullimin e të parit, paralizën cerebrale, distrofinë muskulare apo çrregullimet degjenerative.

Çrregullimet e koordinimit motor ndahen nga dëmtimet motore me natyrë mjekësore. Fëmijët me çrregullime të koordinimit motor kanë riskun të kenë ecuri të dobët në shkollë, vetë-respekt të ulët dhe mungesë të pjesëmarrjes në veprimtari fizike. Ata frustrohen kur u kërkohet të angazhohen në aktivitete fizike.

Çrregullimet motore karakterizohen nga vështirësia për të planifikuar, organizuar dhe kryer një detyrë. Që të ndodhë planifikimi motor duhet që fëmija të formojë ide mbi atë se çfarë do të bëjë, të organizojë hapat në kontekstin e detyrës dhe të kryejë sipas radhës, me qetësi e saktësi lëvizjet e planifikuara.

Tabloja e fëmijës me çrregullime motore shumë shpejt komplikohet. Ai mund të jetë i pakënaqur, i vetmuar, dhe vetëbesim të dobët. Ai zhvillon probleme të sjelljes, të tilla si shmangia, refuzimi për t'u angazhuar apo tërheqja. Sjelljet e fëmijës mund të jenë rezultat i frustrimit. Arsyet e shmangies apo refuzimit për t'u angazhuar mund të jenë vështirësi si: vëmendja e varfër; vështirësitë në filtrimin e informacionit ndijor, paaftësitë në prodhimin e reagimeve të përshtatshme ndaj ndijimeve, etj.

Mësuesi, prindi dhe psikologu shikojnë për prani të shenjave karakteristike të çrregullimeve motore. Këta fëmijë duket se janë në ankth për të lëvizur, nuk rrinë dot ulur, dhe kur u duhet të ulen, lëvizin

këmbë e duar pa kuptim; bëhen shumë shpejt pis; nuk koordinojnë lëvizjet për t'u ruajtur nga ushqimi, shiu, balta; përplasen me të gjithë dhe gjithshka; nuk kanë durim të ngjisin dhe të zbresin shkallët si të tjerët; kanë probleme të lidhin këpucët, kopsat, zinxhirët; nuk orientohen dot në kohë; nuk përdorin me kujdes gërshërët, thikën, pirunin, gjilpërën; kanë vështirësi në lojën me blloqe, lego, biçikletë, top, patina; e kanë të vështirë të ngjyrosin, veçanërisht pjesë e vogla dhe lodhen shpejt kur shkruajnë apo përqendrohen në një aktivitet.

## **6.a. Çrregullimi i lëvizjeve stereotipike Kodi: 307.3 (F98.4) ((i lehtë, i moderuar, i rëndë: me/pa dëmtim të vetes)**

Kriteret e vlerësimit të çrregullimit të lëvizjeve stereotipike përfshijnë:

- A.** Lëvizje motorike pa kuptim, përsëritëse, të nxitura së brendshmi (lëvizja e dorës, lëkundja e trupit, përplasje e kokës, kafshimi, goditja e trupit)
- B.** Lëvizje përsëritëse që ndërhyjnë në zhvillimin social, veprimtaritë shkollore dhe që mund të çojnë në vetëdëmtim.
- C.** Shenjat e mësipërme kanë filluar në fëmijërinë e hershme
- D.** Shenjat e mësipërme nuk mund të jenë pasojë e substancave ose rrethanave të veçanta neurologjike (trikotilomania, OCD)

Një pjesë e fëmijëve më çrregullime neurozhvillimore zhvillojnë lëvizje stereotipike, d.m.th. lëvizje identike, të pakuptimta prej të cilave nuk dalin dot. Ky lloj çrregullimi gjendet shpesh tek fëmijët me autizëm apo me paaftësi mendore. Fëmija tipikisht kryen lëvizje të dorës, lëkundje të saj, lëvizje e cila intensifikohet kur fëmija është i shqetësuar. Fëmija mund të lëvizë njërin dorë ose të dyja. Lëvizja e dorës/duarve nuk shërben për të komunikuar nevoja të veçanta të fëmijës apo reagime specifike ndaj stimuljeve në mjedis. Lëvizja e dorës mund të jetë lëvizje e lirë, (fëmija lëviz dorën/duart në ajër) ose lëvizje stereotipike me një objekt në dorë. Fëmija mund të ketë objekt/objekte të preferuara që i manipulon me dorë/gishta. Shumë preferojnë librat/revistat. Ata mund t'i shfletojnë thuajse gjatë gjithë kohës që janë zgjuar. Po ashtu mund të luajnë me objekte që nuk kanë domethënie të veçantë për ta po që fëmija axhitohet se tepërmi po të mos ketë akses në to. Janë kryesisht objekte të vogla plastike (luge plastike, pipëz, lodër, pjesë lodre, kapackë, etj.) Mungesa e objektit me të cilën luan fëmija mund të shkaktojë shqetësim dhe axhitim ekstrem. Në kësi rastesh, angazhimi i fëmijës me aktivitete të tjera është thuajse i pamundur.

## **7. ÇRREGULLIMET NEUROZHVILLIMORE TË PASPECIFIKUARA Kodi: 315.9 (F89)**

Kjo diagnozë vihet kur shenjat janë të pranishme, po nuk i përmbushin kriteret numerike dhe/apo cilësore të diagnozës (nuk janë as në numër dhe as në masën apo ashpërsinë e shprehjes). Psikologu shkollor vendos për mënyrat e trajtimit apo referimin e fëmijës në shërbime terapeutike jashtë shkollës në rastin e çrregullimeve të paspecifikuara.

## VEPRIMTARI

### SITUATË:

Në shkollën tuaj ju kërkohet të vlerësoni një fëmijë me çrregullime neurozhvillimore. Shikoni më poshtë listat e kontrollit për çdo çrregullim. Duke punuar në grupe, tregoni se në ç'rrethana e mjedise do ta vëzhgoni sjelljen e sugjeruar.

Pasi të keni rënë dakord për rrethanat dhe mjediset e vrojtimit të sjelljeve kriter për çrregullimet neurozhvillimore, paraqitini gjetjet tuaja në tabelën/tabelat përkatëse. Me tabelat e plotësuara gjatë trajnimit, krijoni një portofol të cilit mund t'i referoheni më vonë në praktikën tuaj. Për këtë ju vlen udhëzimi që vijon.

### UDHËZIM:

Më poshtë jepet një model se si të tabelohen të dhënat e mbledhura gjatë vrojtimit të fëmijës dhe si të përlogariten matjet për të përcaktuar praninë e çrregullimit.

Kur tabelohen të dhënat e mbledhura nga vrojtimit, veprohet si më poshtë:

Në kolonën **I** gjenden kriteret e çrregullimit.

Në kolonën **II** gjenden sjelljet që do të vrojtohen. Në këtë kolonë, në krah të cdo sjelljeje shënohen me /✓/ sjelljet tipike të moshës dhe me /X/ sjelljet që nuk jenë tipike për moshën. (Sjelljet jotipike për moshën zbriten nga totali i sjelljeve të vrojuara në përlogaritjet për diagnozën).

Në kolonën **II**, pas sjelljes shënohet se ku do të trajtohet sjellja:

- në PEI (program edukativ individual, i cili hartohet dhe zbatohet në shkollë nga mësuesi, prindi dhe psikologu);
- në PMS (program i mbështetjes sociale, i cili hartohet dhe realizohet nga familjarët me aktorë komunitarë, jashtë shkolle);
- në PKMS (plani i koordinuar i mbështetjes sociale, i cili hartohet dhe realizohet nga shërbimi psikologjik, social, mjekësor pranë bashkisë apo drejtorisë arsimore).

Në kolonën **III** vendosen gjetjet tuaja të shprehura në numra. Vendos "1" kur shprehia mungon dhe "4" kur shprehia është e pranishme tek fëmija. Shkallët "2" dhe "3" përdoren kur shprehia është në formim e sipër.

Në kolonën **IV** nxirret totali i PEI, PMS dhe PKMS. Ai do të orientojë më vonë hartuesit e programeve të ndërhyrjes.

Në rreshtin **Totali** vendosen gjetjet të shprehura me thyesë. Sa më i ulët vlera e thyesës (totali i pikëve të fituara) në fund të matjes së parë, aq me pranë diagnozës është fëmija.

Kjo shkallë mund të përdoret edhe për matjet e përvitshme (matja 2, 3). Totali i pikëve të fituara në vrojtim krahasohet vit pas viti.

Gjetjet mund të përdoren si indikator i cilësisë së ndërhyrjes me anë të PEI, PMS, PKMS dhe ashpërsisë së diagnozës.



# VEPRIMTARIA 1.

## ÇRREGULLIMET E KOMUNIKIMIT

**Objektivat:** Njohja e grupit të çrregullimeve të komunikimit dhe kodeve respektive sipas DSM-V;  
Grupimi i karakteristikave për secilin nga çrregullimet e komunikimit;  
Tabelimi i të dhënave në instrumentin e vlerësimit;  
Interpretimi i të dhënave dhe diagnostikimi.

**Koha:** 2 orë

**Mjetet:** Tabela të çrregullimeve të komunikimit për çdo pjesëmarrës;  
Laptop, projektor, fotokopje;  
Video;  
Flip-charts, markers, handouts për çrregullimet e komunikimit (pjesa teorike) dhe përshkrimi i një rasti.

### Zhvillimi i veprimtarisë:

**Hapi I:** Prezantim (40 min)  
Prezantohen objektivat e sesionit.  
Prezantohen çrregullimet e komunikimit nga trajneri: çrregullimet gjuhësore, çrregullimet e mbajtjes së gojës, çrregullimet e të folurit dhe të çrregullimet e pragmatizmit të komunikimit. Theksohen kriteret e diagnostikimit sipas DSM-v. Tregohen sjelljet përmes të cilave vlerësohen kriteret.  
Prezantohen tabelat e vlerësimit për diagnostikimin e grup çrregullimeve të komunikimit.  
Prezantohet mënyra e tabelimit të të dhënave për çrregullimet.

**Hapi II:** Diskutim 15 min  
Pjesëmarrësit ndajnë me grupin raste të fëmijëve më çrregullime të ndryshme të komunikimit. Pjesëmarrësit tregojnë trajtat e karakteristikave të çdo çrregullimi në grupin e çrregullimeve të komunikimit.

**Hapi III:** Punë në grupe: 30 min  
Pjesëmarrësit ndahen në 4 grupe dhe plotësojnë në çdo grup nga një tabelë të çrregullimeve të komunikimit:  
Grupi A: tabelën e çrregullimeve gjuhësore  
Grupi B: tabelën e çrregullimeve të të folurit  
Grupi C: tabelën e çrregullimeve të pragmatizmit të komunikimit;  
Grupi D: tabelën e çrregullimeve të mbajtjes së gojës;

**Hapi IV:** Prezantim në grupe: 25 min  
Pjesëmarrësit rigrupohen në grupe mikse dhe prezantojnë secili tabelën e grupit të vet (grupet kanë minimumi 4 anëtarë që kanë përgatitur secili tabelën e një çrregullimi). Gjatë prezantimit secili prej tyre plotëson një kopje table ndërkohë që dëgjon prezantimin.

**Hapi V:** Mbyllja e seancës: 10 min  
Pjesëmarrësit japin feedback për punët e paraqitura. Çdo pjesëmarrës c çel Portofolin e Instrumenteve të Diagnostikimit të Çrregullimeve Neurozhvillimore dhe vendos në të tabelën përkatëse sipas Kodit të DSM-V.

## 1.a. Çrregullimet gjuhësore Kodi: 315.39 (F80.9)

### Grupi A:

Ilustrohen grup çrregullimet gjuhësore me video deri në 2-3 min si dhe/ose me një përshkrim rasti.

- Përshkruajeni sjelljen e fëmijës me çrregullime gjuhësore.
- Krahasojeni atë me të fëmijëve të tjerë në klasë. Me kë ju ngjason? Nga se ndryshojnë?
- Dallojeni fëmijën me çrregullime gjuhësore. Ku do të përqendroheni? Cili është tipari më dallues?
- Analizoje sjelljen. Tregoni komponentët e çrregullimeve gjuhësore të fëmija. Krahasojini gjetjet me komponentët e instrumentit për këtë çrregullim.
- Zbatoni instrumentin: Tregoni se ç'mund të bëni me të? Si mund ta përdorni? Sa siguri keni? Sa e vështirë është?
- Arsyeto pro ose kundër përdorimit të instrumentit. Cilat pjesë do të ndryshonit?
- Mbaj një qëndrim ndaj kësaj pjesë të instrumentit. Sa ju vlen ta përdorni për të vlerësuar praninë e çrregullimeve gjuhësore.

### Shkalla e vlerësimit për çrregullimet gjuhësore (Tabela jepet e plotësuar për të shërbyer si model)

|   |  |   |  |
|---|--|---|--|
| 4 | Nxënësi zotëron shprehinë: e përdor i pavarur në familje, grup, shkollë e komunitet, | 3 | Nxënësi pothuajse e zotëron shprehinë, |
| 2 | Shprehia është në formim e sipër,  | 1 | Nxënësi nuk e zotëron shprehinë.       |

| Kriteret diagnostikuese sipas DSM-V | Listë kontrolli për verifikimin e çrregullimeve gjuhësore (përzgjidh shprehitë që vlerësohen tek nxënësi, shëno nivelin duke përdorur shkallën më sipër)   | Matja 1<br>Data:<br>5/5/2017  | Matja 2<br>Data:<br>5/5/2018 | Matja 3<br>Data:<br>5/5/2019 | Komente                   |
|-------------------------------------|--|---|------------------------------|------------------------------|---------------------------|
| Fjalor i varfër                     | <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Përdor foljet që tregojnë veprim PMS</li> <li>✓ Tregon emrin, datën, adresën, familjarët PMS</li> <li>✓ Përsërit fjalë me më shumë se 3 rrokje PEI</li> <li>✓ Tregon nevojat e tij PEI/PMS</li> <li>✓ Përshkruan emocionet tek të tjerët PEI</li> <li>X Krijon dhe shpreh mendim të pavarur N/A</li> <li>✓ Tregon një ngjarje reale PEI/PMS</li> <li>✓ Riprodhon një pjesë të lexuar/dëgjuar PEI/PMS</li> </ul> | <p>3</p> <p>2</p> <p>3</p> <p>3</p> <p>1</p> <p>0</p> <p>1</p> <p>1</p> |                              |                              | PEI:5<br>PMS: 5<br>PKMS:0 |
| TOTALI                              | <b>Shënim:</b> Tipike për moshën janë 7/8 sjelljet e mësipërme. Totali i prituri i pikëve maksimale është 28.  | <b>14 /28</b>   |                              |                              |                           |

|   |   |               |   |   |                           |
|---|---|---------------|---|---|---------------------------|
| Strukturë e varfër e fjalive            | <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Ndërton fjali të thjeshta PEI/PMS 4</li> <li>✓ Ndërton fjali të përbëra (2 ose më shumë pjesë) PEI 2</li> <li>✓ Vendos theksin logjik të fjalisë ku duhet PEI/PMS 1</li> <li>✓ Ruan strukturën e fjalisë gjatë të folurit PEI 2</li> <li>✓ Këmben vendin e fjalëve në fjali sipas nevojës PEI 1</li> <li>X E kthen fjalinë në trajta pyetëse dhe mohore N/A 0</li> </ul>                           |               |   |   | PEI: 5<br>PMS:2           |
| TOTALI                                  | <b>Shënim:</b> Tipike për moshën janë 5/6 sjelljet e mësipërme. Totali i pritur i pikëve maksimale është 24.  | <b>10/24</b>  | / | / |                           |
| Çrregullime të bashkëbisedimit          | <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Fillon bashkëbisedimin PEI/PMS 1</li> <li>✓ Ka kontakt me sy me bashkëfolësin PMS 2</li> <li>✓ Pret radhën të flasë PEI/PMS 2</li> <li>✓ U përgjigjet pyetjeve PEI/PMS 3</li> <li>✓ Pyet bashkëbiseduesin me interes PMS 1</li> <li>✓ Qëndron në bashkëbisedim aq sa është e nevojshme PEI/PMS 2</li> <li>✓ Ndahet pa problem nga bashkëbiseduesi PMS 2</li> </ul>                                 |               |   |   | PEI:4<br>PMS: 7<br>PKMS:0 |
| TOTALI                                  | <b>Shënim:</b> Tipike për moshën janë 7/7 sjelljet e mësipërme. Totali i pritur i pikëve maksimale është 28.  | <b>13 /28</b> | / | / |                           |
| Paftësi për të komunikuar përmes gjuhës | <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Përdor gjuhën për të shprehur mendimet PEI 1</li> <li>✓ Përdor gjuhën për të shprehur nevojat PMS 3</li> <li>✓ Përdor gjuhën për të treguar emocionet PEI/PMS 1</li> <li>✓ Përdor gjuhën për të kërkuar PEI/PMS 2</li> <li>✓ Përdor gjuhën për të kundërshtuar PEI/PMS 1</li> <li>✓ Përdor gjuhën për t'u ankuar PEI/PMS 1</li> <li>✓ Përshtat fjalorin, intonacionin, strukturën PEI 1</li> </ul> |               |   |   | PEI:6<br>PMS: 5<br>PKMS:0 |
| TOTALI                                  | <b>Shënim:</b> Tipike për moshën janë 7/7 sjelljet e mësipërme. Totali i pritur i pikëve maksimale është 28.  | <b>10 /28</b> | / | / |                           |

|   |   |  |   |   |   |
|---|---|--|---|---|---|
| Mungesë e pjesëmarrjes në grup apo e shoqërimit me të tjerë | <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Ulet pranë të tjerëve PMS</li> <li>✓ Kërkon të marrë pjesë në grup PEI</li> <li>✓ Diskuton në grup PEI/PMS</li> <li>✓ Ndjek rregullat e punës në grup PEI</li> <li>✓ Luan me të tjerët në pushim PEI</li> <li>✓ Kupton qëllimet e të tjerëve në grup PEI/PMS</li> <li>✓ Përshtat reagimin në grup PEI/PMS</li> </ul>                                 | <p>4</p> <p>2</p> <p>1</p> <p>1</p> <p>1</p> <p>1</p> <p>2</p> |   |   | PEI:6<br>PMS: 4<br>PKMS:0                         |
| TOTALI  | <b>Shënim:</b> Tipike për moshën janë 7/7 sjelljet e mësipërme. Totali i pritur i pikëve maksimale është 28.  | <b>12/28</b>   | / | / |   |
| Mungesë e arritjeve akademike                               | <ul style="list-style-type: none"> <li>✓ Pëlqen mësimin dhe detyrat PEI</li> <li>✓ Punon i pavarur për të kryer detyrat në shkollë PEI</li> <li>✓ Kryen detyrat në kohë PEI/PMS</li> <li>✓ Është krenar për arritjet personale PEI/PMS</li> <li>✓ Ka interes të zgjerojë njohuritë PEI/PMS</li> <li>X Është krijuar e i pavarur N/A</li> <li>✓ Ndan me të tjerët atë që di PEI/PMS</li> </ul> | <p>1</p> <p>2</p> <p>1</p> <p>1</p> <p>1</p> <p>0</p> <p>2</p> |   |   | PEI:6<br>PMS: 4<br>PKMS:0                         |
| TOTALI  | <b>Shënim:</b> Tipike për moshën janë 6/7 sjelljet e mësipërme. Totali i pritur i pikëve maksimale është 24.  | <b>8 /24</b>   | / | / |   |
| <b>KRITERET:</b><br><br><b>6/6</b>                          | <b>Nxënësi përfton më pak se 50% të pikëve të vlerësimit ndaj diagnostikohet si “fëmijë me çrregullime gjuhësore”.</b>  | <b>67/160</b><br><b>67&lt;80</b>                               | / | / | <b>PEI: 32</b><br><b>PMS: 27</b><br><b>PKMS:0</b> |

## 1.b. Çrregullimet e të folurit Kodi: 315.39 (F80.0)

### Grupi B

- Lexoni kriteret të diagnostikimit të fëmijëve me çrregullime të të folurit.

Kujtoni një fëmijë që i ka manifestuar tërësisht ose pjesërisht ato.

Për secilin nga kriteret listoni një numër veprimtarish të përshtatshme që duhen vrojtuar për të diagnostikuar fëmijën.

- Lexoni rastin e mëposhtëm:

*“Toni është një fëmijë 6 vjeçar. Aftësitë e tij për t’u shprehur janë poshtë nivelit të fëmijëve të klasës së tij. Ai ka dëgjim normal dhe aftësitë perceptuese janë të përafërta me fëmijë të moshës së tij, por Toni shqipton më pak tinguj se fëmijët e tjerë. Ai është i qetë, por bën shumë gabime kur folur. Ai gjatë shqiptimit të fjalëve heq shumë tinguj, sidomos ato që janë në fund të fjalës. Kur i jepen të përsërisë fjalë, ai bën një mori parregullish në tinguj; i zëvendëson me të tjerë ose heq një pjesë të tyre.”*

- Përkruajeni sjelljen e fëmijës me çrregullime të të folurit.

- Krahasojeni atë me të fëmijëve të tjerë në klasë. Me kë ju ngjason? Nga se ndryshojnë?
- Dallojeni fëmijën me çrregullime të të folurit. Ku do të përqendrohëni? Cili është tipari më dallues?
- Analizojeni sjelljen e fëmijës me çrregullime të të folurit. Tregoni komponentët e çrregullimit tek fëmija. Krahasojini gjetjet me komponentët e instrumentit për këtë çrregullim.
- Zbatoni instrumentin: Tregoni se c'mund të bëni me të? Si mund ta përdorni? Sa siguri keni? Sa e vështirë është?
- Arsyeto pro ose kundër përdorimit të instrumentit. Cilat pjesë do të ndryshonit?
- Mbaj një qëndrim ndaj kësaj pjesë të instrumentit. Sa ju vlen ta përdorni për të vlerësuar praninë e çrregullimeve të të folurit?
- Plotësoni tabelën me gjetjet tuaja:

### Shkalla e vlerësimit për çrregullimet e të folurit:

|          |  |          |  |
|----------|--|----------|--|
| <b>4</b> | Nxënësi zotëron shprehinë: e përdor i pavarur në familje, grup, shkollë e komunitet, | <b>3</b> | Nxënësi pothuajse e zotëron shprehinë, |
| <b>2</b> | Shprehia është në formim e sipër,  | <b>1</b> | Nxënësi nuk e zotëron shprehinë.       |

| Kriteret diagnostikuese sipas DSM-V | Listë kontrolli për verifikimin e çrregullimeve të të folurit (përzgjidh gjithshka që vëren tek nxënësi, trego nivelin duke përdorur shkallën më sipër:  | Matja 1<br>Data: | Matja 2<br>Data: | Matja 3<br>Data: | Komente |
|-------------------------------------|--|------------------|------------------|------------------|---------|
| Paftësi në prodhimin e tingujve     | <input type="checkbox"/> Artikulon zanoret (fonemat) _____<br><input type="checkbox"/> Artikulon bashkëtingëlloret (fonemat) _____<br><input type="checkbox"/> Artikulon diftongje _____<br><input type="checkbox"/> Vendos bashkëtingëllore pranë zanoreve _____<br><input type="checkbox"/> Artikulon fjalë me 2-3 bashkëtingëllore radhë _____  |                  |                  |                  |         |
| TOTALI                              |  | /                | /                | /                |         |
| Paftësi në artikulimin e fjalëve    | <input type="checkbox"/> Ndërton fjali të thjeshta _____<br><input type="checkbox"/> Ndërton fjali të përbëra (2 ose më shumë pjesë) _____<br><input type="checkbox"/> Artikulon fjali me intonacionin e duhur _____<br><input type="checkbox"/> Përdor pjesët e fjalisë në format e duhura _____<br><input type="checkbox"/> Përshtat pjesët e fjalisë _____<br><input type="checkbox"/> E kthen fjalinë në trajta pyetëse dhe mohore _____ |                  |                  |                  |         |
| TOTALI                              |  | /                | /                | /                |         |
| KRITERET: /                         |  |                  |                  |                  |         |

## 1.c. Çrregullimi i pragmatizmit të komunikimit (komunikimit social) Kodi: 315.39 (F80.89)

### Grupi C:

- Lexoni kriteret e mëposhtme që diagnostikimit të fëmijëve me çrregullime të pragmatizmit të komunikimit (çrregullime të komunikimit social). Kujtoni një fëmijë që i ka manifestuar tërësisht ose pjesërisht ato. Për secilin nga kriteret listoni një numër aktivitete të përshtatshme që duhen vrojtuar për të diagnostikuar fëmijën.
- Përshkruajeni sjelljen e fëmijës me çrregullim të pragmatizmit të komunikimit.
- Krahasojeni atë me të fëmijëve të tjerë në klasë. Me kë ju ngjason? Nga se ndryshojnë?
- Dallojeni fëmijën me çrregullim të pragmatizmit të komunikimit. Ku do të përqendrohemi? Cili është tipari më dallues?
- Analizojeni sjelljen. Tregoni komponentët e çrregullimeve të pragmatizmit të komunikimit të fëmija. Krahasojini gjetjet me komponentët e instrumentit për këtë çrregullim.
- Zbatoni instrumentin: Tregoni se ç'mund të bëni me të? Si mund ta përdorni? Sa siguri keni? Sa e vështirë është?
- Arsyetoni pro ose kundër përdorimit të instrumentit. Cilat pjesë do të ndryshonit?
- Mbani një qëndrim ndaj kësaj pjese të instrumentit. Sa ju vlen ta përdorni për të vlerësuar praninë e çrregullimeve të pragmatizmit të komunikimit?

Plotësoni tabelën me gjetjet tuaja:

### Shkalla e vlerësimit për çrregullimin e pragmatizmit të komunikimit:

|   |  |   |  |
|---|--|---|--|
| 4 | Nxënësi zotëron shprehinë: e përdor i pavarur në familje, grup, shkollë e komunitet, | 3 | Nxënësi pothuajse e zotëron shprehinë, |
| 2 | Shprehia është në formim e sipër,  | 1 | Nxënësi nuk e zotëron shprehinë.       |

| Kriteret diagnostikuese sipas DSM V  | Listë kontrolli për verifikimin e çrregullimit të pragmatizmit të komunikimit (përzgjidh shprehitë që vëren tek nxënësi, trego nivelin duke përdorur shkallën më sipër:  | Matja 1<br>Data: | Matja 2<br>Data: | Matja 3<br>Data: | Komente |
|--|--|------------------|------------------|------------------|---------|
| Paaftësi në përdorimin e komunikimit për qëllime sociale .                   | <input type="checkbox"/> Formulon opinionet e tij/saj _____<br><input type="checkbox"/> Argumenton qëndrimet e tij/saj _____<br><input type="checkbox"/> Mban anë në diskutime _____<br><input type="checkbox"/> Njeh shtresëzimet gjuhësore _____<br><input type="checkbox"/> Shoqëron gjuhën me emocione _____   |                  |                  |                  |         |
| TOTALI   |  | /                | /                | /                |         |
| Paaftësi për të përshtatur komunikimin me kontekstin dhe nevojat e dëgjuesit | <input type="checkbox"/> Fillon një bashkëbisedim _____<br><input type="checkbox"/> Qëndron në bashkëbisedim deri në fund _____<br><input type="checkbox"/> Zgjedh tema, përshtat interesat e tij/saj dhe dëgjuesit _____<br><input type="checkbox"/> Kupton dhe ndjek radhën e të folurit _____<br><input type="checkbox"/> Kupton nëse bashkëfolësi ka interes për temën _____<br><input type="checkbox"/> Përdor stilin bisedor të të folurit _____ |                  |                  |                  |         |
| TOTALI   |  | /                | /                | /                |         |

|  |  |   |   |   |  |
|--|--|---|---|---|--|
| Vështirësi në ndjekjen e rregullave të bashkëbisedimit | <input type="checkbox"/> Ruan qetësinë gjatë bashkëbisedimit _____<br><input type="checkbox"/> Respekton mjedisin ku bisedohet _____<br><input type="checkbox"/> Përdor intonacionin e duhur _____<br><input type="checkbox"/> Zgjedh lartësinë e zërit në funksion të qëllimit _____<br><input type="checkbox"/> Flet dhe lejon të tjerët të flasin _____ |   |   |   |  |
| TOTALI   |  | / | / | / |  |
| Vështirësi në të kuptuarit e gjuhës metaforike         | <input type="checkbox"/> Njeh metaforën në të folur _____<br><input type="checkbox"/> Përdor metaforën në të folur _____<br><input type="checkbox"/> Përdor fjalët në të gjitha kuptimet e tyre _____<br><input type="checkbox"/> Reagon emocionalisht në bashkëbisedim _____<br><input type="checkbox"/> Vijon komunikimin metaforik pa vështirësi _____  |   |   |   |  |
| TOTALI   |  | / | / | / |  |
| KRITERET: /  |  |   |   |   |  |

## 1.d. Çrregullimi i mbajtjes së gojës Kodi: 315.35 (F80.81)

### Grupi D:

- Lexoni kriteret e mëposhtme që diagnostikimit të fëmijëve me çrregullime të mbajtjes së gojës. Kujtoni një fëmijë që i ka manifestuar tërësisht ose pjesërisht ato. Për secilin nga kriteret listoni një numër aktivitete të përshtatshme që duhen vrojtuar për të diagnostikuar fëmijën.
- Kujtoni fëmijët që njihni se u mbahet goja. Shikoni aspektet e mëposhtme të mbajtjes së gojës dhe kujtoni praninë e tyre.
  - A shfaq fëmija tone muskulore dhe/ose lëvizje të pavullnetshme, lëvizje të shpejta të pavullnetshme të kokës, nofullës, fytyrës, gjuhës, qiellzës, fytyrës, gjatë qëndrimeve të pandërprera dhe gjatë lëvizjes?
  - A shfaq fëmija frymënxjerrje të papritur, të sforcuar, ndalesa zëri, dhe/ose ndalim frymëmarrje të përkohshme?
  - A shfaq fëmija variacione të papritura, të çrregullta/të tepruara në lartësinë e zërit?
  - A shfaq fëmija ndërprerje të fonimit ritmik?
  - A prodhon fëmija intervale të zgjata dhe/ose heshtje të papërshtatshme gjatë prodhimit të të folurit?
  - A i zgjat fonemat?
  - A shfaq ndryshueshmëri të të foluri?
  - A flet me fraza të shkurtra?
  - A shfaq theks të tepruar, joeficient?
  - A ka fëmija mioklonus (dridhje të pavullnetshme ose të parregullta të një pjese të trupit), tike (lëvizje të shpejta, të parregullta), korea (lëvizje të një pjese të trupit të shpejta, jo të rregullta, të pavullnetshme, rastësore, të paqëllimshme)?
  - A shfaq fëmija lëvizje artikuluese të ngadalta ose të paqarta?
  - A shfaq “fillime false” me fillimin e prodhimit të të folurit?
  - A ka vështirësi me ritmin, kohëzgjatjen, dhe/ose lartësinë?
- Përshkruajeni sjelljen e fëmijës me çrregullim të mbajtjes së gojës.
- Krahasojeni atë me të fëmijëve të tjerë në klasë. Me kë ju ngjason? Nga se ndryshojnë?
- Dallojeni fëmijën me çrregullim të mbajtjes së gojës. Ku do të përqendrohemi? Cili është tipari më dallues?

- Analizoje sjelljen. Tregoni komponentët e çrregullimit të mbajtjes së gojës. Krahasojini gjetjet me komponentët e instrumentit për këtë çrregullim.
- Zbatoni instrumentin: Tregoni se c'mund të bëni me të? Si mund ta përdorni? Sa siguri keni? Sa e vështirë është?
- Arsyetoni pro ose kundër përdorimit të instrumentit. Cilat pjesë do të ndryshonit?
- Mbani qëndrim ndaj kësaj pjese të instrumentit. Sa ju vlen ta përdorni për të vlerësuar praninë e çrregullimeve të pragmatizmit të komunikimit?

Plotësoni tabelën me gjetjet tuaja:

### Shkalla e vlerësimit për mbajtjen e gojës:

|          |  |          |  |
|----------|--|----------|--|
| <b>4</b> | Nxënësi zotëron shprehinë: e përdor i pavarur në familje, grup, shkollë e komunitet, | <b>3</b> | Nxënësi pothuajse e zotëron shprehinë, |
| <b>2</b> | Shprehia është në formim e sipër,  | <b>1</b> | Nxënësi nuk e zotëron shprehinë.       |

| <b>Kriteret diagnostikuese sipas DSM-V</b>         | Listë kontrolli për verifikimin e çrregullimit të mbajtjes së gojës (përzgjidh shprehitë që vlerësohen tek nxënësi, trego nivelin duke përdorur shkallën më sipër:   | <b>Matja 1</b><br>Data | <b>Matja 2</b><br>Data | <b>Matja 3</b><br>Data | <b>Komente</b> |
|--|--|------------------------|------------------------|------------------------|----------------|
| Ndërprerje të rrjedhshmërisë normale të të folurit | Rrjedhshmëri në prodhimin e tingujve dhe rrokjeve _____<br>Zgjatje normale në kohë e tingujve dhe rrokjeve _____<br>Rrjedhshmëri në prodhimin e fjalëve disarrokëshë _____<br>Rrjedhshmëri në prodhimin e fjalisë _____<br>Përdorim me qëllim të pauzave në mes të fjalisë _____                   |                        |                        |                        |                |
| <b>TOTALI</b>                                      |  | /                      | /                      | /                      |                |
| Vështirësi në shtrirjen e të folurit në kohë       | Çtensionim gjatë të folurit _____<br>Fillim i butë i fjalëve _____<br>Fillim i butë i fjalive _____<br>Shtrirje e të folurit në kohë _____<br>Luhatje e intonacionit sipas kuptimit _____<br>Vendosje e theksit logjik mbi fjalët e rëndësishme _____<br>Kuptueshmëri maksimale e të folurit _____ |                        |                        |                        |                |
| <b>TOTALI</b>                                      |  | /                      | /                      | /                      |                |
| Mospërshtatje e cilësisë së të folurit me moshën   | Përdor stilin bisedor të të folurit _____<br>Shpreh mjaftueshëm nevojat dhe interesat e moshës _____<br>Zgjedh intonacionin e duhur _____<br>Të folurit është i kuptueshëm _____   |                        |                        |                        |                |
| <b>TOTALI</b>                                      |  | /                      | /                      | /                      |                |



|                    |   |   |   |   |  |
|--------------------|---|---|---|---|--|
| Ankth nga e folura | Të folurit është i çtensionuar _____<br>Nuk vërehen lëvizje të pakuptimta të pjesëve të trupit _____<br>Përzgjidhje e fjalëve që tejkëojnë saktë mendimin _____<br>Ka siguri kur flet _____ |   |   |   |  |
| TOTALI             |   | / | / | / |  |
| KRITERET: /        |   |   |   |   |  |

## VEPRIMTARIA 2

### ÇRREGULLIME TË SPEKTRIT TË AUTIZMIT Kodi: 299.00 (F84.0)

**Objektivat:** Njohja e grupit të çrregullimeve të spektrit të autizmit dhe kodeve respektive sipas DSM-V;  
Grupimi i karakteristikave për çrregullimet e spektrit të autizmit;  
Tabelimi i të dhënave në instrumentin e vlerësimit;  
Interpretimi i të dhënave dhe diagnostikimi.

**Koha:** (1.5 orë)

**Mjetet:** Tabela CAS;  
Lap top, projektor, fotokopje;  
Video;  
Flip-charts, markers, handouts për CAS (pjesa teorike) dhe përshkrimi i një rasti.

**Hapi I:** Prezantim 30 min  
Prezantohen objektivat e sesionit.  
Prezantohen CAS nga trajneri. Theksohen kriteret e diagnostikimit sipas DSM-v.  
Tregohen sjelljet përmes të cilave vlerësohen kriteret.  
Ilustrohen CAS me video deri në 2-3 min si dhe me një përshkrim rasti.  
Prezantohet tabela e vlerësimit për diagnostikimin e CAS.  
Prezantohet mënyra e tabelimit të të dhënave për CAS.

**Hapi II:** Diskutim: 10 min  
Pjesëmarrësit ndajnë me grupin raste të fëmijëve me CAS. Pjesëmarrësit tregojnë trajtat e karakteristikave të tyre.

**Hapi III:** Punë në grupe: 20 min  
Pjesëmarrësit ndahen në 2 grupe dhe plotësojnë secilin nga kriteret e CAS:  
Grupi A: Deficite të përhershme në komunikimin dhe ndërveprimin social;  
Grupi B: Sjellje të kufizuara përsëritëse, interesa dhe aktivitete të kufizuara.

**Hapi IV:** Prezantim në çifte: 20 min  
Pjesëmarrësit rigrupohen në çifte A dhe B dhe prezantojnë secili tabelën e grupit. Gjatë prezantimit, secili prej tyre plotëson një kopje tablele ndërkohë që dëgjon prezantimin.

**Hapi V:** Mbyllja e seancës: 10 min  
Pjesëmarrësit japin feedback për punët e paraqitura. Çdo pjesëmarrës shton në Portofolin e Instrumenteve të Diagnostikimit të Çrregullimeve Neurozhvillimore tabelën përkatëse të CAS me Kodin e DSM-V.

### Grupi A:

Lexoni kriterin e parë të diagnostikimit të fëmijëve me çrregullime të spektrit të autizmit (CAS). Kujtoni një fëmijë që i ka manifestuar tërësisht ose pjesërisht ato. Për secilin nga kriteret listoni një numër aktivitetesh të përshtatshme që duhen vrojtuar për të diagnostikuar fëmijën.

- Përshkruajeni sjelljen e fëmijës me karakteristikat e mësipërme.
- Krahasojeni atë me të fëmijëve të tjerë në klasë. Me kë ju ngjason? Nga se ndryshojnë?
- Dallojeni fëmijën me çrregullim të spektrit të autizmit. Ku do të përqendroheni? Cili është tipari më dallues?
- Analizoni sjelljen. Tregoni komponentët e çrregullimit të spektrit të autizmit. Krahasojini gjetjet me komponentët e instrumentit për këtë çrregullim.
- Zbatoni instrumentin: Tregoni se c'mund të bëni me të? Si mund ta përdorni? Sa siguri keni? Sa e vështirë është?
- Arsyetoni pro ose kundër përdorimit të instrumentit. Cilat pjesë do të ndryshonit?
- Mbani qëndrim ndaj kësaj pjese të instrumentit. Sa ju vlen ta përdorni për të vlerësuar praninë e çrregullimeve të spektrit të autizmit?

### Grupi B:

Lexoni kriterin e dytë të diagnostikimit të fëmijëve me çrregullime të spektrit të autizmit (CAS). Kujtoni një fëmijë që i ka manifestuar tërësisht ose pjesërisht ato. Për secilin nga kriteret listoni një numër aktivitetesh të përshtatshme që duhen vrojtuar për të diagnostikuar fëmijën.

- Përshkruajeni sjelljen e fëmijës me karakteristikat e mësipërme.
- Krahasojeni atë me të fëmijëve të tjerë në klasë. Me kë ju ngjason? Nga se ndryshojnë?
- Dallojeni fëmijën me çrregullim të spektrit të autizmit. Ku do të përqendroheni? Cili është tipari më dallues?
- Analizoni sjelljen. Tregoni komponentët e çrregullimit të spektrit të autizmit. Krahasojini gjetjet me komponentët e instrumentit për këtë çrregullim.
- Zbatoni instrumentin: Tregoni se c'mund të bëni me të? Si mund ta përdorni? Sa siguri keni? Sa e vështirë është?
- Arsyetoni pro ose kundër përdorimit të instrumentit. Cilat pjesë do të ndryshonit?
- Mbani qëndrim ndaj kësaj pjese të instrumentit. Sa ju vlen ta përdorni për të vlerësuar praninë e çrregullimeve të spektrit të autizmit?

Plotësoni tabelën me gjetjet tuaja:

## Shkalla e vlerësimit për çrregullimet e spektrit të autizmit:

|   |  |   |  |
|---|--|---|--|
| 4 | Nxënësi zotëron shprehinë: e përdor i pavarur në familje, grup, shkollë e komunitet, | 3 | Nxënësi pothuajse e zotëron shprehinë, |
| 2 | Shprehia është në formim e sipër,  | 1 | Nxënësi nuk e zotëron shprehinë.       |

| Kriteret diagnostikuese sipas DSM-V                                     | Listë kontrolli për verifikimin e çrregullimet e spektrit të autizmit (përzgjidh shprehitë që vlerëson tek nxënësi, trego nivelin duke përdorur shkallën më sipër)   | Matja 1<br>Data | Matja 2<br>Data | Matja 3<br>Data | Komente |
|---|--|-----------------|-----------------|-----------------|---------|
| Mungesa (deficite) të përhershme në komunikimin dhe ndërveprimin social | <p>Sillet me të tjerët në përshtatje me moshën _____</p> <p>Ruan kontaktin me sy gjatë komunikimit _____</p> <p>Ndahet lehtësisht nga prindërit _____</p> <p>Përfshihet me të tjerët në veprimtari _____</p> <p>Imiton të tjerët sipas nevojës _____</p> <p>Përdor pozicionin e trupit, shprehjet e fytyrës, fjalët dhe sjelljet për të shprehur emocionet _____</p> <p>Shfaq frikë, ankth dhe nervozizëm normal _____</p> <p>Përdor gjuhën e shkruar dhe të folur në përshtatje me moshën _____</p> <p>Përdor komunikimin joverbal (gjuhën e trupit) sipas rastit dhe nevojës _____</p> <p>Ka nivel inteligjence në përshtatje me moshën _____</p> <p>Reagon ndaj ndërhyrjeve/udhëzimeve të të rriturve _____</p> |                 |                 |                 |         |
| TOTALI  |  | /               | /               | /               |         |
| Sjellje të kufizuara përsëritëse, interesa dhe veprimtari të kufizuara  | <p>Koordinon lëvizjet në përputhje me qëllimin _____</p> <p>Kontrollon lëvizjet kur i kërkohet _____</p> <p>Ka interes për një spektër të gjerë lojërash dhe lodrash _____</p> <p>Përshtatet me ndryshimet e rutinës _____</p> <p>Përdor shikimin normalisht (largësia, këndi, interesi) _____</p> <p>Reagon ndaj asaj që dëgjon _____</p> <p>Reagon normalisht ndaj shijeve, erërave dhe prekjes _____</p> <p>Reagon normalisht ndaj dhimbjes _____</p> <p>Shfaq nivel normal të angazhimit në veprimtari dhe lojë _____</p>  |                 |                 |                 |         |
| TOTALI  |  | /               | /               | /               |         |
| KRITERET /  |  |                 |                 |                 |         |

## VEPRIMTARIA 3:

### ÇRREGULLIMET E INHIBIMIT

(çrregullim i lehtë, i moderuar, i rëndë) (1.5 ore)

**3.a. ADHD (tipi i çrregullimit të vëmendjes me hiperaktivitet, niveli i lehtë, i moderuar, i rëndë) Kodi: 314.01 (F90.2)**

**3.b. ADD (tipi i çrregullimit të vëmendjes, niveli: i lehtë i moderuar, i rëndë) Kodi: 314.00 (F90.0)**

**3.c. HD (tipi i çrregullimit të hiperaktivitetit, niveli: i lehtë i moderuar, i rëndë) Kodi: 314.01 (F90.1)**

**Objektivat:** Njohja e grupit të çrregullimeve të inhibimit (ADD, HD, ADHD) dhe kodeve respektive sipas DSM-V;

Grupimi i karakteristikave për çrregullimet inhibimit;

Tabelimi i të dhënave në instrumentin e vlerësimit;

Interpretimi i të dhënave dhe diagnostikimi.

**Koha:** 1.5 orë

**Mjetet:** Tabela e çrregullimeve të inhibimit (ADD, HD, ADHD);

Lap top, projektor, fotokopje;

Video;

Flip-charts, markers, handouts për CAS (pjesa teorike) dhe përshkrimi i një rasti.

**Hapi I:** Prezantim (25 min)

Prezantohen objektivat e sesionit.

Prezantohen çrregullimet e inhibimit (ADD, HD, ADHD) nga trajneri. Theksohen kriteret e diagnostikimit sipas DSM-v. Tregohen sjelljet përmes të cilave vlerësohen kriteret.

Ilustrohen grupi i çrregullimeve të inhibimit (ADD, HD, ADHD) me video deri në 2-3 min si dhe me përshkrime rastesh.

Prezantohet tabela e vlerësimit për diagnostikimin e grupit të çrregullimeve të inhibimit (ADD, HD, ADHD).

Prezantohet mënyra e tabelimit të të dhënave për grupin e çrregullimeve të inhibimit (ADD, HD, ADHD).

**Hapi II:** Diskutim (15 min)

Pjesëmarrësit ndajnë me grupin raste të fëmijëve me çrregullime të inhibimit (ADD, HD, ADHD).

Pjesëmarrësit tregojnë trajtat e karakteristikave të tyre si grup dhe veçmas për çdo nënndarje (ADD, HD, ADHD).

**Hapi III:** Punë në grupe (20 min)

Pjesëmarrësit ndahen në 3 grupe dhe plotësojnë secili tabelën përkatëse të çdo çrregullimi inhibimit:

Grupi A: ADD,

Grupi B: HD,

Grupi C: ADHD.

**Hapi IV:** Prezantim: (20 min)  
Pjesëmarrësit rigrupohen. Përfaqësues të secilit grup (A, B, C) prezantojnë secili tabelën e grupit. Gjatë prezantimit, çdo pjesëmarrës plotëson një kopje tablele ndërkohë që dëgjon prezantimin.

**Hapi V:** Mbyllja e seancës: (10 min)  
Pjesëmarrësit japin feedback për punët e paraqitura. Çdo pjesëmarrës shton në Portofolin e Instrumenteve të Diagnostikimit të Çrregullimeve Neurozhvillimore tabelën përkatëse të grupit të çrregullimeve të inhibimit (ADD, HD, ADHD) me Kodin përkatës të DSM-V.

## Rast me ADHD

*“Franci është një djalë 7 vjeç që ndjek klasën e parë. Ai njihet si një djalë shumë i lëvizshëm që nuk lë dy gurë bashkë. Në klasë është djali “më trazovaç”, mezi rri ulur, lëviz në karrige si trupin ashtu edhe këmbët. Ka raste që ngrihet nga karrigia dhe lëviz nëpër klasë, pavarësisht kërkesave të mësueses për t’u ulur. Një ditë shkoi para klasës dhe filloi të këndonte, ndërkohë që të tjerët merreshin me detyrat që kishte dhënë mësuesja.*

*Ai shkon dobët me mësimet. Njëh disa shkronja dhe numra, por ka vështirësi në kryerjen e detyrave më komplekse. Mësuesja ia shënon detyrat në fletore që ai të mos i harrojë.*

*Nëse mësuesja e thërret, duket sikur nuk ekziston asnjë person me atë emër në klasë. Ai nuk reagon dhe vazhdon të kryejë ato aktivitete që janë në interesin e tij.*

*Edhe në shtëpi nuk i bindet kërkesave apo urdhrave të prindërve.*

*Si fëmijë “i pabindur” dënohet shpesh. Ai nuk ka shokë as në shkollë dhe as në lagje, sepse u prish rregullat e lojës dhe nuk respekton as radhën, as të tjerët. Me shokun e bankës zihet shume. Shpesh herë shoku i bankës ankohet së Franci e shtyn, nuk e lë të shkruajë, i prish fletoret.*

*Edhe me vëllanë e madh ka të njëjtën marrëdhënie. Nëna e tij rrëfen e lodhur: “Nuk ja heq dot sytë për asnjë moment sepse e di që ai do të bëjë një prapësi. Prek gjithçka, e kthen shtëpinë mbrapsht. Vrapon dhe kacavirret kudo. Kur i flas më duket sikur i flas murit, as që më dëgjon fare. Mësuesja ankohet vazhdimisht për sjelljen e tij dhe thujse çdo ditë na çon nga një shënim në fletore. Sinqerisht nuk di si të sillem, I kam provuar të gjitha: me të mira dhe me të këqija.”*

- Përshkruajeni sjelljen e fëmijës me karakteristikat e mësipërme.
- Krahasojeni atë me të fëmijëve të tjerë në klasë. Me kë ju ngjason? Nga se ndryshojnë?
- Dallojeni fëmijën me çrregullim të inhibimit. Ku do të përqendroheni? Cili është tipari më dallues?
- Analizoje sjelljen. Tregoni përbërësit e çrregullimit të inhibimit. Krahasojini gjetjet me komponentët e instrumentit për këtë çrregullim.
- Zbatoni instrumentin: Tregoni se c’mund të bëni me të? Si mund ta përdorni? Sa siguri keni? Sa e vështirë është?
- Arsyetoni pro ose kundër përdorimit të instrumentit. Cilat pjesë do të ndryshonit?
- Mbani qëndrim ndaj kësaj pjese të instrumentit. Sa ju vlen ta përdorni për të vlerësuar praninë e çrregullimeve të inhibimit?

Plotësoni tabelën me gjetjet tuaja:

## Shkalla e vlerësimit të çrregullimeve të inhibimit:

|   |  |   |  |
|---|--|---|--|
| 4 | Nxënësi zotëron shprehinë: e përdor i pavarur në familje, grup, shkollë e komunitet, | 3 | Nxënësi pothuajse e zotëron shprehinë, |
| 2 | Shprehia është në formim e sipër,  | 1 | Nxënësi nuk e zotëron shprehinë.       |

| Kriteret diagnostikuese sipas DSM-V                      | Listë kontrolli për verifikimin e çrregullimit të ADD/HD/ADHD (përzgjidh shprehitë që vëren tek nxënësi, trego nivelin duke përdorur shkallën më sipër)   | Matja 1<br>Data | Matja 2<br>Data | Matja 3<br>Data | Komente |
|--|---|-----------------|-----------------|-----------------|---------|
| Pavëmendje e përhershme                                  | <p>Arrin të përqendrohet _____</p> <p>Ruan vëmendjen në detyrë ose lojë _____</p> <p>Dëgjon kur i drejtohen atij/asaj drejtpërdrejt _____</p> <p>Ndjek udhëzimet _____</p> <p>Mbaron detyrat pa u fokusuar në gjëra anësore _____</p> <p>Bën organizmin e vogël të detyrave/veprimtarive _____</p> <p>Përfshihet në detyra që kërkojnë përpjekje mendore _____</p> <p>Dëgjon kur i drejtohen atij/asaj drejtpërdrejt _____</p> <p>Kanë rregull në mjediset e punës _____</p> <p>Ruan sendet e veta _____</p>  |                 |                 |                 |         |
| TOTALI   |   | /               | /               | /               |         |
| Hiperaktivitet dhe impulsivitet i përhershëm/qëndrueshëm | <p>Lëviz gjymtyrët me masë _____</p> <p>Bën lëvizje të qëllimta _____</p> <p>Qëndron në vendin e punës në përshtatje me qëllimin _____</p> <p>Ecën dhe vrapon kur duhet _____</p> <p>Luan me qetësi një lojë deri në fund _____</p> <p>Aktivizon kujtesën afatshkurtër dhe afatgjatë _____</p> <p>Lëviz me masë _____</p> <p>Ka interes për zërat dhe zhurmat afër _____</p> <p>Përgjigjet pasi ka dëgjuar pyetjen _____</p> <p>Pret radhën në bashkëbisedim _____</p> <p>Ruan radhën e kryerjes së veprimeve _____</p> <p>Respekton të tjerët në bashkëbisedim _____</p> |                 |                 |                 |         |
| TOTALI   |   | /               | /               | /               |         |
| KRITERET /   |   |                 |                 |                 |         |

## VEPRIMTARIA 4:

### ÇRREGULLIME SPECIFIKE TË TË NXËNIT (të lehta, të moderuara, të rënda) (3 orë)

#### 4.a. Çrregullimet në lexim (disleksi) Kodi: 315.00 (F81.0)

#### 4.b. Çrregullimet në shkrim Kodi: 315.2 (F81.81)

#### 4.c. Çrregullimet në matematike Kodi: 315.1 (F81.2)

**Objektivat:** Njohja e grupit të çrregullimeve specifike të të nxënit: disleksia, disgrafia, diskalkulia dhe njohja e kodeve respektive sipas DSM-V;  
Grupimi i karakteristikave për secilin nga çrregullimet specifike në të nxënë dhe identifikimi i rasteve komorbide;  
Tabelimi i të dhënave në instrumentin e vlerësimit;  
Interpretimi i të dhënave dhe diagnostikimi me çrregullimet specifike në të nxënë.

**Koha:** 3 orë

**Mjetet:** Tabela të çrregullimeve specifike në të nxënë: diskalkulia, disgarifa, disleksia për çdo pjesëmarrës;  
Lap top, projektor, fotokopje;  
Video;  
Flip-charts, markers, handouts për çrregullimet specifike në të nxënë (pjesa teorike) dhe përshkrimi i një rasti për çdo çrregullim: disleksi, diskalkuli, disgrafi.

**Hapi I:** Prezantim: 40 min  
Prezantohen objektivat e sesionit.  
Prezantohen çrregullimet specifike në të nxënë nga trajneri: disleksia, diskalkuli, disgrafia.  
Theksohen kriteret e diagnostikimit sipas DSM-v për secilin prej tyre. Tregohen sjelljet përmes të cilave vlerësohen kriteret.  
Ilustrohen çdo me video deri në 2-3 min si dhe me një përshkrim rasti specifik.  
Prezantohen tabelat e vlerësimit për diagnostikimin e çrregullimeve specifike në të nxënë.  
Prezantohet mënyra e tabelimit të të dhënave për çrregullimet e disleksisë, disgrafisë, diskalkulisë.

**Hapi II:** Diskutim: 30 min  
Pjesëmarrësit ndajnë me grupin raste të fëmijëve me çrregullime specifike të të nxënit. Pjesëmarrësit tregojnë trajtat e karakteristikave të çdo çrregullimi. Ata tregojnë komorbitetin mes tyre.

**Hapi III:** Punë në grupe: 40 min  
Pjesëmarrësit ndahen në 3 grupe dhe plotësojnë në çdo grup nga një tabelë të çrregullimeve specifike të të nxënit:  
Grupi A: tabelën e çrregullimit të disleksisë;  
Grupi B: tabelën e çrregullimeve të disgrafisë;  
Grupi C: tabelën e çrregullimeve të diskalkulisë.

Çdo grup përcakton edhe pjesët më të përshtatshme të kurrikulës për të bërë vrojtimet dhe matjet.

**Hapi IV:** Prezantim në grup: 45 min  
Çdo grup prezanton çrregullimin e vet si dhe mënyrën e mbledhjes dhe dokumentimit të të dhënave.

**Hapi V.** Punë në grupe treshe: 25 min  
Pjesëmarrësit rigrupohen në grupe treshe (një pjesëmarrës nga çdo grup: A, B, C) dhe plotësojnë tabelat e çdo çrregullimi.

**Hapi VI:** Mbyllja e seancës: 10 min  
Pjesëmarrësit japin feedback për punët e paraqitura. Çdo pjesëmarrës çel Portofolin e Instrumenteve të Diagnostikimit të Çrregullimeve Neurozhvillimore dhe vendos në të tabelat përkatëse sipas Kodit të DSM-V.

#### 4.a. Çrregullimet në lexim (disleksia) Kodi: 315.00 (F81.0)

##### Grupi A: (handout për çrregullimin e disleksisë)

Fëmijët me çrregullim të leximit kanë këto vështirësi në të lexuar:

- Lexojnë jashtëzakonisht shumë ngadalë.
- Shtrembërojnë fjalët.
- Ankohen se u mjegullohen fjalët.
- Lexojnë keq fjalët që janë të ngjashme.
- Gabojnë kur lexojnë fjalë që kanë shumë rrokje.
- Harrojnë lidhëset mes fjalëve.
- Kanë vështirësi në të kuptuarit e fjalive të përbëra.
- Kanë vështirësi në të kuptuarit e fjalive.
- Kanë vështirësi në të kuptuarit e fjalive të përbëra.
- Ankohen kur lexojnë në letër të bardhë.
- Kanë vështirësi me simbolet matematikore.
- Përshkruajeni sjelljen e fëmijës me karakteristikat e mësipërme.
- Krahasojeni atë me të fëmijëve të tjerë në klasë. Me kë ju ngjason? Nga se ndryshojnë?
- Dallojeni fëmijën me çrregullim të leximit. Ku do të përqendrohemi? Cili është tipari më dallues?
- Analizojeni sjelljen. Tregoni përbërësit e çrregullimit të leximit. Krahasojini gjetjet me përbërësit e instrumentit për këtë çrregullim.
- Zbatoni instrumentin: Tregoni se ç'mund të bëni me të? Si mund ta përdorni? Sa siguri keni? Sa e vështirë është?
- Arsyetoni pro ose kundër përdorimit të instrumentit. Cilat pjesë do të ndryshonit?
- Mbani qëndrim ndaj instrumentit. Sa ju vlen ta përdorni për të vlerësuar praninë e çrregullimeve të leximit?

Plotësoni tabelën me gjetjet tuaja:



## Shkalla e vlerësimit për çrregullimet në lexim:

|   |  |   |  |
|---|--|---|--|
| 4 | Nxënësi zotëron shprehinë: e përdor i pavarur në familje, grup, shkollë e komunitet, | 3 | Nxënësi pothuajse e zotëron shprehinë, |
| 2 | Shprehia është në formim e sipër,  | 1 | Nxënësi nuk e zotëron shprehinë.       |

| Kriteret diagnostikuese sipas DSM-V                | Listë kontrolli për verifikimin e çrregullimit të disleksisë përzgjidh shprehitë që vëren tek nxënësi, trego nivelin duke përdorur shkallën më sipër:   | Matja 1<br>Data | Matja 2<br>Data | Matja 3<br>Data | Komente |
|--|---|-----------------|-----------------|-----------------|---------|
| Gabime në lexim                                    | Lexon pa gabime _____<br>Ruan rrjedhshmërinë e të folurit _____<br>Ruan njëtrajtshmërinë e lëvizjes së syve dhe kokës kur lexon _____<br>Nuk shënjon me gisht atë që lexon _____<br>Respekton radhën e fjalëve, fjalive, rreshtave, paragrafëve _____<br>Dallon shkronja të ngjashme ( /b-d/, /n-m/ _____<br>Shquan shkronjat e tingujve të ngjashëm ( /f-v/, /d-t) _____ |                 |                 |                 |         |
| TOTALI   |   | /               | /               | /               |         |
| Përpjekje e dukshme gjatë leximit                  | Ruan pozicionin e trupit kur lexon _____<br>Ruan shikimin në faqen e librit gjatë leximit _____<br>Shmang lëvizjet e panevojshme kur lexon _____<br>Lexon me ëndje _____<br>Shoqëron me sy atë që lexon _____   |                 |                 |                 |         |
| TOTALI   |   | /               | /               | /               |         |
| Avashllëk në të lexuar                             | Kupton atë që lexon _____<br>Lexon qartë _____<br>Ruan tempin e leximit _____<br>Lexon rrjedhshëm _____   |                 |                 |                 |         |
| TOTALI   |   | /               | /               | /               |         |
| Pamundësi për të nxjerrë kuptim nga pjesa e lexuar | Kumton të kuptuarit e tij për atë që lexon _____<br>Vesh pjesën e lexuar me intonacionin e duhur _____<br>Lexon fjalën dhe fjalinë deri në fund _____<br>Artikulon të gjitha fjalët e fjalisë _____<br>Vendos theksin logjik aty ku duhet _____   |                 |                 |                 |         |
| TOTALI   |   | /               | /               | /               |         |
| KRITERET /   |   |                 |                 |                 |         |

## 4.b. Çrregullimet në shkrim (disgrafia) Kodi: 315.2 (F81.81) 30-minuta

### Grupi B: (handout për çrregullimin e disgrafisë)

Fëmijët me disgrafi nxënë, por thjesht nxënë ndryshe nga të tjerët. Llogaritet që IQ-ja e tyre të jetë mbi mesataren. Për shkak të asimetrisë së trurit ata i shikojnë shkronjat në tri dimensionet e tyre (3D), gjë që bën që shkronjat të deformohen p.sh “p” bëhet “d”

Fëmijët me çrregullim të shkrimit kanë vështirësitë e mëposhtme në të shkruar:

- Vështirësi në shqiptimin e fjalëve të cilat janë të ngjashme.
- Shkruajnë të njëjtën fjalë ndryshe në të njëjtin paragraf. *P.sh fjala literaturë e shkruan një herë literatura, letratura, lataratura etj.*
- Iu duhet shumë kohë për të mbajtur mend diçka, më shumë se 2000 herë për të mbajtur mend një fjalë ndërsa një jo disleksiku rreth 14 herë.
- Bëjnë përzjerje apo mungesë të shkronjave.
- E kanë shumë të vështirë që të lexojnë atë që kanë shkruar vetë.
- E kanë të vështirë të marrin shënime kur lexojnë.
- E kanë të vështirë të shkruajnë qartë, qoftë edhe kur kopjojnë.
- E kanë shumë të vështirë të shkruajnë shpejt.
- E kanë të vështirë të shprehin qartë idetë me shkrim.
- Shkrimi mbetet si i një fëmije të klasës së parë.
- Kanë mungesë e shenjave të pikësimit.
- Ndryshojnë shkronjat dhe numrat.
- Përshkruajeni sjelljen e fëmijës me karakteristikat e mësipërme.
- Krahasojeni atë me të fëmijëve të tjerë në klasë. Me kë ju ngjason? Nga se ndryshojnë?
- Dallojeni fëmijën me çrregullim të paspecifikuar të komunikimit. Ku do të përqendroheshi? Cili është tipari më dallues?
- Analizoje sjelljen. Tregoni përbërësit e çrregullimit të paspecifikuar të komunikimit. Krahasojini gjetjet me përbërësit e instrumentit për këtë çrregullim.
- Zbatoni instrumentin: Tregoni se c'mund të bëni me të? Si mund ta përdorni? Sa siguri keni? Sa e vështirë është?
- Arsyeto pro ose kundër përdorimit të instrumentit. Cilat pjesë do të ndryshonit?
- Mbaj qëndrim ndaj kësaj pjese të instrumentit. Sa ju vlen ta përdorni për të vlerësuar praninë e çrregullimeve të pragmatizmit të komunikimit?

## Shkalla e vlerësimit për çrregullimet në shkrim:

|   |  |   |  |
|---|--|---|--|
| 4 | Nxënësi zotëron shprehinë: e përdor i pavarur në familje, grup, shkollë e komunitet, | 3 | Nxënësi pothuajse e zotëron shprehinë, |
| 2 | Shprehia është në formim e sipër,  | 1 | Nxënësi nuk e zotëron shprehinë.       |

| Kriteret diagnostikuese sipas DSM-V   | Listë kontrolli për verifikimin e çrregullimit të disgrafisë<br>(përzgjidh shprehitë që vëren tek nxënësi, trego nivelin duke përdorur shkallën më sipër:   | Matja 1<br>Data | Matja 2<br>Data | Matja 3<br>Data | Komente |
|---------------------------------------|---|-----------------|-----------------|-----------------|---------|
| Vështirësi në drejtshkrim             | Ruan llojin e shkrimit (shkrim me shkronja shtypi, korsive,) _____<br>Shkruan qartë dhe lexueshëm _____<br>Ruan drejtimin e leximit _____<br>Ruan hapësirën mes shkronjave _____<br>Ruan hapësirën mes rreshtave _____<br>Përqendron sytë tek ajo që shkruan _____  |                 |                 |                 |         |
| TOTALI                                |   | /               | /               | /               |         |
| Vështirësi në të shprehurit me shkrim | Përballon, pa u lodhur, detyrat me shkrim _____<br>Përfundon detyrat me shkrim në kohë _____<br>Shmang sforcimin gjatë shkrimit _____<br>Ndërton fjali e paragrafë të saktë me shkrim _____<br>Shmang bjerrjen e fjalëve kryesore dhe lidhëse në shkrim _____<br>Kopjon pa gabime _____<br>Përdor rregullat e drejtshkrimit _____ |                 |                 |                 |         |
| TOTALI                                |   | /               | /               | /               |         |
| KRITERET /                            |   |                 |                 |                 |         |

## 4.c. Çrregullimet në matematikë (diskalkulia) Kodi: 315.1 (F81.2)

### Grupi C:

Lexoni kriteret e mëposhtme që diagnostikimit të fëmijëve me çrregullime specifike të të nxënësve në matematikë. Kujtoni një fëmijë që i ka manifestuar tërësisht ose pjesërisht ato. Për secilin nga kriteret, listoni një numër veprimtarish të përshtatshme që duhen vrojtuar për të diagnostikuar fëmijën.

## Shkalla e vlerësimit për çrregullimet në matematikë:

|          |  |          |  |
|----------|--|----------|--|
| <b>4</b> | Nxënësi zotëron shprehinë: e përdor i pavarur në familje, grup, shkollë e komunitet, | <b>3</b> | Nxënësi pothuajse e zotëron shprehinë, |
| <b>2</b> | Shprehia është në formim e sipër,  | <b>1</b> | Nxënësi nuk e zotëron shprehinë.       |

| <b>Kriteret diagnostikuese sipas DSM-V</b>                 | Listë kontrolli për verifikimin e çrregullimit të diskalkulisë (përzgjidh shprehitë që vëren tek nxënësi, trego nivelin duke përdorur shkallën më sipër:  | <b>Matja 1</b><br>Data | <b>Matja 2</b><br>Data | <b>Matja 3</b><br>Data | <b>Komente</b> |
|--|---|------------------------|------------------------|------------------------|----------------|
| Vështirësi të mësojë numrin dhe përlogaritjet matematikore | Njeh numrat pa gabime _____<br>Kthen mbrapsht numrat pa gabime (24 : 42) _____<br>Ruan radhën e numrave kur i kopjon nga libri/tabela _____<br>Shkruan numrin saktë kur e dëgjon _____<br>Njeh dhe përdor drejt shenjat e "+", "-", ":", "x" dhe "=" _____<br>Kryen pa gabim veprimet bazë matematikore _____ |                        |                        |                        |                |
| <b>TOTALI</b>  |   | /                      | /                      | /                      |                |
| Vështirësi në arsyetimin matematikor                       | Njeh tabelat e mbledhjes, zbritjes, shumëzimit dhe pjesëtimit sipas programit _____<br>Njeh rendin e numrave (dhjetëshet, qindëshet, mijëshet) _____<br>Lexon një problem dhe përpunon kërkesat e tij _____<br>Kupton njësitë bazë matëse: km, orë, kg, etj. _____  |                        |                        |                        |                |
| <b>TOTALI</b>  |   | /                      | /                      | /                      |                |
| <b>KRITERET /</b>  |   |                        |                        |                        |                |

## VEPRIMTARIA V

### ÇRREGULLIMET MOTORE Kodi 315.4 (F82) 9

- Objektivat:** Njohja e grupit të çrregullimeve motore dhe kodeve respektive sipas DSM-V;  
Grupimi i karakteristikave për çrregullimet motore;  
Tabelimi i të dhënave në instrumentin e vlerësimit;  
Interpretimi i të dhënave dhe diagnostikimi.
- Koha:** (1.5 orë)
- Mjetet:** Tabela e çrregullimeve motore;  
Lap top, projektor, fotokopje;  
Video;  
Flip-charts, markers, handouts për CAS (pjesa teorike) dhe përshkrimi i një rasti.
- Hapi I:** Prezantim: 30 min  
Prezantohen objektivat e sesionit.  
Prezantohen çrregullimet motore nga trajneri. Theksohen kriteret e diagnostikimit sipas DSM-V. Tregohen sjelljet përmes të cilave vlerësohen kriteret.  
Ilustrohen çrregullimet motore me video deri në 2-3 min si dhe me një përshkrim rasti.  
Prezantohet tabela e vlerësimit për diagnostikimin e çrregullimeve motore.  
Prezantohet mënyra e tabelimit të të dhënave për çrregullime motore.
- Hapi II:** Diskutim: 10 min  
Pjesëmarrësit ndajnë me grupin raste të fëmijëve me çrregullime motore. Pjesëmarrësit tregojnë trajtat e karakteristikave të tyre.
- Hapi III:** Punë në grupe: 20 min  
Pjesëmarrësit ndahen në 2 grupe dhe plotësojnë secilin nga çrregullimet motore:  
Grupi A: Çrregullimet motore  
Grupi B: Çrregullimet e lëvizjeve stereotipike
- Hapi IV:** Prezantim në çifte: 20 min  
Pjesëmarrësit rigrupohen në çifte A dhe B dhe prezantojnë secili tabelën e grupit. Gjatë prezantimit, secili prej tyre plotëson një kopje tablele ndërkohë që dëgjon prezantimin.
- Hapi V:** Mbyllja e seancës: 10 min  
Pjesëmarrësit japin feedback për punët e paraqitura. Çdo pjesëmarrës shton në Portofolin e Instrumenteve të Diagnostikimit të Çrregullimeve Neurozhvillimore tabelën përkatëse të CAS me Kodin e DSM-V.

#### 5.a. Çrregullimet motore

##### Grupi A:

- Lexoni kriteret e mëposhtme që diagnostikimit të fëmijëve me çrregullime motore. Kujtoni një fëmijë që i ka manifestuar tërësisht ose pjesërisht ato. Për secilin nga kriteret, listoni një numër aktivitetesh të përshtatshme që duhen vrojtuar për të diagnostikuar fëmijën.
- Njihuni me rastet dhe diskutoni rreth tyre:

*Ana shfaq destabilitet postural. Ajo ecën me vështirësi. Përgjithësisht tonusi i muskujve të saj është i dobët. Ajo i lëviz buzët me vështirësi, ngadalë. Duart e saj janë të buta si simite. Të folurit i ngadaltë, i vështirë për tu kuptuar. Ana edhe kokën nuk e ngre kur flet. As nuk të shikon në sy. Sa më shumë kohë kalon aq më shumë izolohet Ana.*

*Ani ka lëvizje të çuditshme të gojës dhe fytyrës kur flet. Të folurit e tij është i ndërprerë, shpërthyes. Ani ka kontraktime të trupit gjatë të folurit dhe shpesh e shoqëron atë me këmbë e me duar. Kur flet duket se lodhet shumë.*

- Përshkruajeni sjelljen e fëmijës me karakteristikat e mësipërme.
- Krahasojeni atë me të fëmijëve të tjerë në klasë. Me kë ju ngjason? Nga se ndryshojnë?
- Dallojeni fëmijën me çrregullime motore. Ku do të përqendrohemi? Cili është tipari më dallues?
- Analizojeni sjelljen. Tregoni përbërësit e çrregullimeve motore. Krahasojini gjetjet me përbërësit e instrumentit për këtë çrregullim.
- Zbatoni instrumentin: Tregoni se ç'mund të bëni me të? Si mund ta përdorni? Sa siguri keni? Sa e vështirë është?
- Arsyetoni pro ose kundër përdorimit të instrumentit. Cilat pjesë do të ndryshoni?
- Mbani qëndrim ndaj kësaj pjese të instrumentit. Sa ju vlen ta përdorni për të vlerësuar praninë e çrregullimeve motore?

### Shkalla e vlerësimit për çrregullimet motore:

|   |  |   |  |
|---|--|---|--|
| 4 | Nxënësi zotëron shprehinë: e përdor i pavarur në familje, grup, shkollë e komunitet, | 3 | Nxënësi pothuajse e zotëron shprehinë, |
| 2 | Shprehia është në formim e sipër,  | 1 | Nxënësi nuk e zotëron shprehinë.       |

| Kriteret diagnostikuese sipas DSM-V                                    | Listë kontrolli për verifikimin e çrregullimit motore (përzgjidh shprehitë që vëren tek nxënësi, trego nivelin duke përdorur shkallën më sipër:  | Matja 1<br>Data | Matja 2<br>Data | Matja 3<br>Data | Komente |
|--|--|-----------------|-----------------|-----------------|---------|
| Përfitimi dhe ekzekutimi i lëvizjeve është i papërshtatshëm për moshën | Lëviz sipas nevojës _____<br>Kontrollon ankthin gjatë lëvizjes _____<br>Kur ulet, pozicionon trupin dhe qetësohet _____<br>Orientohet në hapësirë, duke shmangur përplasjet _____<br>Koordinon lëvizjet kur i duhet të kalojë pengesa _____<br>Kryen saktë veprime të motorikës fine (lidh, shkruan) _____<br>Orientohet në kohë _____<br>Përdor me lehtësi mjetet shkollore (gërshërë, kompas, lapsa, ngjyra) _____ |                 |                 |                 |         |
| TOTALI   |  | /               | /               | /               |         |
| Çrregullimi i lëvizjes pengon të nxënësit e shprehive të reja          | Mëson lëvizje të sporteve të ndryshme _____<br>Mëson shprehi të reja të motorikës gros _____<br>Mëson shprehi të reja të motorikës fine _____<br>Mëson veprime të përshtatshme _____<br>Komenton lëvizjen si "të saktë" ose "të gabuar" _____  |                 |                 |                 |         |
| TOTALI   |  | /               | /               | /               |         |
| KRITERET /   |  |                 |                 |                 |         |

## 5.b. Çrregullimi i lëvizjeve stereotipike Kodi: 307.3 (F98.4) ((i lehtë, i moderuar, i rëndë: me/pa dëmtim të vetes)

### Shkalla e vlerësimit për çrregullimet e lëvizjeve stereotipike:

|          |  |          |  |
|----------|--|----------|--|
| <b>4</b> | Nxënësi zotëron shprehinë: e përdor i pavarur në familje, grup, shkollë e komunitet, | <b>3</b> | Nxënësi pothuajse e zotëron shprehinë, |
| <b>2</b> | Shprehia është në formim e sipër,  | <b>1</b> | Nxënësi nuk e zotëron shprehinë.       |

| <b>Kriteret diagnostikuese sipas DSM-V</b>  | Listë kontrolli për verifikimin e çrregullimit të lëvizjeve stereotipike (përzgjidh shprehitë që vëren tek nxënësi, trego nivelin duke përdorur shkallën më sipër:   | <b>Matja 1</b><br>Data | <b>Matja 2</b><br>Data | <b>Matja 3</b><br>Data | <b>Komente</b> |
|---|--|------------------------|------------------------|------------------------|----------------|
| Lëvizje motorike pa kuptim, përsëritëse, të nxitura së brendshmi  | Kontrollon lëvizjet e motorikës së madhe _____<br>Kontrollon lëvizjet e motorikës fine _____<br>Kryen lëvizje të qëllimta _____<br>Ruan kontrollin mbi shpejtësinë dhe mjedisin _____<br>Planifikon energjinë gjatë lëvizjes _____<br>Ruan trupin kur lëviz _____                                |                        |                        |                        |                |
| <b>TOTALI</b>   |  | /                      | /                      | /                      |                |
| Përsëritje e disa lëvizjeve që ndërhyjnë në zhvillimin social, veprimtaritë shkollore dhe që mund të çojnë në vetë-dëmtim | Përdor veprimtarit sportive për t'u shoqëruar me të tjerët _____<br>Kupton qëllimin e lojërave sportive _____<br>Luan për të fituar _____<br>Ndjek rregullat e lojës _____<br>Respekton shokët në lojë _____<br>Pranon rezultatin _____<br>Bashkëpunon me skuadrën për të arritur qëllimin _____ |                        |                        |                        |                |
| <b>TOTALI</b>   |  | /                      | /                      | /                      |                |
| <b>KRITERET /</b>   |  |                        |                        |                        |                |

## ÇRREGULLIMET NEUROZHVILLIMORE TË PASPECIFIKUARA DHE CRREGULLIMET E PAAFTËSISË INTELEKTUALE

**Çrregullime të paspecifikuara: Kodi: 315. 9 (F89)**

**Paaftësi e lehtë mendore - Kodi: 319 (F70)**

**Paaftësi e moderuar mendore - Kodi: 319 (F71)**

**Paaftësi e rëndë mendore - Kodi: 319 (F72)**

**Paaftësi e thellë mendore - Kodi:319 (F73)**

### **SHËNIM:**

Rastet e fëmijëve më çrregullime neurozhvillimore të papërcaktuara dhe me çrregullime të paaftësisë intelektuale zakonisht vlerësohen në ekipe mjekesh dhe psikologësh jashtë shkollës. Për këtë arsye, ato nuk përfshihen në këtë modul trajnimi. Gjithësesi, shkolla ka përgjegjësinë e përshtatjes së tyre nëse komisioni mjekësor nuk rekomandon vendosjen e tyre në qendra rezidenciale.

- Përshkruajeni sjelljen e fëmijës me karakteristikat e çrregullimeve të paspecifikuara apo të paaftësisë intelektuale.
- Krahasojeni atë me të fëmijëve të tjerë në klasë. Me kë ju ngjason? Nga se ndryshojnë?
- Dallojeni fëmijën me çrregullimeve të paspecifikuara apo të paaftësisë intelektuale.
- Ku do të përqendrohemi? Cili është tipari më dallues?
- Analizoni sjelljen. Tregoni përbërësit e çrregullimeve të paspecifikuara apo të paaftësisë intelektuale.





AGENZIA ITALIANA  
PER LA COOPERAZIONE  
ALLO SVILUPPO



**Save the Children**

Rruga: Mihal Popi, Ndërtesa 7, ish Pallatet 1 Maji, (Vila Lami);  
PO Box 8185, Tiranë - Shqipëri; Tel: +355 4 2261840/ 4 2261929

E-mail: [info.albania@savethechildren.org](mailto:info.albania@savethechildren.org)

[https:// albania.savethechildren.net](https://albania.savethechildren.net)



Savethechildrenal



SaveChildrenAlb